



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.10.2018, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Roland Xhelilaj, Reme Lala, Pjerin Ndreu dhe Ismet Beqiraj.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Evis Kushi, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi - Drejtore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Xhoana Agolli – Drejtore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – Drejtor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Lavdrim Sahitaj- Drejtor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Aurela Velo – Drejtore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Peco – Drejtore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Alba Caroshi- Këshilltare Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Arber Lleshi – Këshilltar Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Lindita Lati - Drejtore e Përgjithshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit
Manjola Naço - Drejtore e Përgjithshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit
Rinald Muça - Drejtor i Departamentit të Performancës, Kontrolli i Lartë i Shtetit
Azmi Stringa – Drejtor Departamenti i Auditimit të Buxhetit Shtetit në Kontrollin e
Lartë të Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit. Siç jeni njoftuar në rendin e ditës së sotme të punës të komisionit kemi vetëm një çështje, shqyrtimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017”, si dhe raportin e KLSH-së mbi buxhetin faktik të vitit 2017.

Për këtë arsye, ndodhen në komision për të prezantuar projektligjin ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj.

Ndërkohë, desha t’ju njoftoj se për shkak të procesit të përfundimit të mandatit dhe njoftimit të këtij fakti nga ana e kryetarit të KLSH-së jo vetëm në këtë komision, por edhe para Presidentit të Republikës, i cili është vënë në dijeni të faktit që zoti Leskaj nuk do të kandidojë më për detyrën e kryetarit të KLSH-së, zoti Leskaj kërkon mirëkuptimin tonë, që të mos jetë prezent në këtë seancë dhe të vijojë me detyrën e kujdestarit në krye të KLSH-së deri në momentin e emërimit të kryetarit të ri të KLSH-së. Për këtë arsye ndodhet në Komisionin e Ekonomisë zonja Lindita Lati, drejtore e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zonja Manjola Naço, drejtore e Përgjithshme, Kontrolli i Lartë të Shtetit dhe zoti Rinald Muça, drejtor i Departamentit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Relatore e komisionit për këtë projektligj është zonja Blerina Gjylameti. Do të procedojmë me prezantimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017”. Më pas, do të vijojmë me opinionin e KLSH-së lidhur me këtë projektligj dhe më tej, do të flasë relatorja e komisionit.

Do të procedojmë më tej me pyetjet e bëra nga deputetët e komisionit e me përgjigjet e pyetjeve, si dhe me diskutimet e deputetëve lidhur me dy aktet e prezantuara në komision.

Fjala është për ministrin!

Arben Ahmetaj - I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Që në fillim dëshiroj të shpreh me bindje përpara këtij komisioni se eksperiencia e buxhetit të vitit 2017, në tërësinë e tij, që prej fazës së programimit, ekzekutimit, monitorimit etj., ishte një tjetër eksperiencë mjaft pozitive, si në aspektin e mirëmenaxhimit të financave

publike, të konsoliduara tashmë, ashtu edhe në kontributin e dhënë në ekonomi dhe në mirëqenien e qytetarëve shqiptarë.

Buxheti i vitit 2017 mundësoi arritjen e disa objektivave thelbësore:

- Viti 2017 ishte viti i parë elektoral parlamentar, që shënoi ulje të borxhit publik, ulje të deficitit dhe balancë primare pozitive, në zbatim të plotë të rregullit fiskal që kjo qeveri e vendosi, pra ndryshe nga trendet historike të menaxhimit të financave publike në vitet elektorale.
- Buxheti i vitit 2017 mundësoi një politikë fiskale optimale, me efekt të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe rritjes së punësimit.
- Mbështetje të vazhdueshme buxhetore ndaj sektorëve privatë, të tillë si: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura.
- Konsolidimi i një sistemi të shëndetshëm të menaxhimit financiar, i cili shmanjë krijimin dhe mbartjen e detyrimeve të reja, të prapambetura financiare;
- Miratimin e ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore dhe fillimi i zbatimit të tij, si një hap cilësor përpara në drejtim të përmirësimit të ndjeshëm të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

Për sa u takon zhvillimeve kryesore makroekonomike dhe parametrave kryesore të qëndrueshmërisë së financave publike gjatë vitit 2017, evidentohet qartësisht se:

Gjatë vitit 2017 ekonomia shqiptare performoi mjaft mirë. Ritmi i rritjes ekonomike vijoi trendin përshpejtues të nisur që prej vitit 2014. Rritja reale ekonomike në vitin 2017 rezultoi 3,84% nga 3,4% në vitin 2016.

Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja përgjatë vitit 2017 u ndikua nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet në ekonomi. Ndërsa kërkesa e huaj neto dha një kontribut negativ në reflektim të rritjes së fortë të importit të mallrave, ndonëse eksportet, si të mallrave, veçanërisht ato të shërbimeve, patën një ecuri mjaft pozitive.

Konkretisht, për sa u takon komponentëve të kërkesës së brendshme agregate rezultoi se konsumi u rrit me 2,7% në terma realë, duke dhënë një kontribut prej 2,5 pikë përqindje në rritjen totale prej 3,8%, ndërsa formimi i kapitalit fiks bruto (pra investimet), u rrit me 6,5% në terma reale, me një kontribut prej 1,6 pikë përqindje në rritjen totale.

Lidhur me komponentët e kërkesës së huaj neto, rezultoi se eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 8,9 % në terma realë, me një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së prej

2,6 pikë përqindje, ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 8,2 % në terma realë, rrjedhimisht me një kontribut negativ prej 3,8 pikë përqindje në rritjen e PBB-së.

Tek importet e vitit 2017 evidentohet kryesisht rritja e lartë e mallrave kapitale të destinuara për investime fizike në ekonomi, por edhe importi i energjisë elektrike, që rezultoi i lartë gjatë vitit 2017, për shkak të thatësisë.

Në anën e ofertës agregate, përveç prodhimit të energjisë elektrike, i cili gjatë vitit 2017 pati një rënie drastike si rrjedhojë e një moti të thatë, të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë rezultuan me rritje pozitive, pra rritja ishte mjaft e diversifikuar. Për sa i takon kontributit të dhënë në rritjen e PBB-së, edhe në reflektim të peshës së lartë, që kanë në strukturën e PBB-së, sektorët kryesorë ishin: ndërtimi, me një kontribut prej 0,9 pikë përqindje (në linjë kjo me ecurinë e investimeve në ekonomi që përmenda më lart);

Industria përpunuese me kontribut prej 0,5 pikë përqindje;

Tregtia, me kontribut 0,5 pikë përqindje;

Kemi dhe një sërë sektorësh me një kontribut më të ulët me 0,2 pikë përqindje -si bujqësia, industria nxjerrëse, transporti, arsimi, shëndetësia, etj.

Këtu dëshiroj të theksoj faktin se rritja ekonomike përçoi efekte mjaft pozitive në tregun e punës, si në uljen e shkallës së papunësisë, ashtu edhe në rritjen e punësimit dhe pjesëmarrjes në forcat e punës. Shkalla e papunësisë për grup-moshën nga 15 – 64 vjeç gjatë vitit 2017 ra në 14,1% nga 15,6 %, që ishte në vitin 2016, ndërkohë që punësimi u rrit me 2,7 % kundrejt vitit 2016, pra një rritje e konsiderueshme, nëse merret parasysh edhe fakti që viti 2016 pati gjithashtu, një rritje të punësimit prej 6,1%, që është një bazë shumë e konsiderueshme.

Gjatë vitit 2017, zhvillime pozitive pati edhe në pozicionin e jashtëm të ekonomisë. Bilanci i pagesave, shënoi rritje në suficitin e tij, duke arritur vlerën + 185,4 milionë euro, nga + 48 milionë euro, që ishte në 2016.

Gjithashtu, deficiti i llogarisë korrente vijoi të tkurret, si në terma absolutë, edhe në një masë domethënëse në raport me PBB-në, duke rezultuar në 6,9 % të PBB-së nga 7,6 % që ishte në vitin 2016. Ky përmirësim i balancës së llogarisë korrente të Shqipërisë ishte kryesisht reflektim i rritjes së eksporteve të mallrave e veçanërisht shërbimeve dhe brenda këtyre të fundit, padyshim spikasin shërbimet e turizmit.

Edhe remitancat gjatë vitit 2017 vijuan me një rritje pozitive.

Në aspektin e pozicionimit të jashtëm të ekonomisë shqiptare përgjatë vitit 2017, deficitin e llogarisë korrente u financua tërësisht me flukse kapitali, të cilat nuk krijojnë borxh të jashtëm, siç janë flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte. Edhe pse gjatë vitit 2017 IHD-të patën një rritje disi më modeste krahasuar me vitin 2016, me rreth 3,3%, sërish ato mbuluan në masën 120% deficitin e llogarisë korrente, i cili përbën një element mjaft të rëndësishëm për sa i takon qëndrueshmërisë së pozicionit të jashtëm të ekonomisë, e rrjedhimisht, stabilitetin makroekonomik. Lidhur me stabilitetin makroekonomik dhe përpjekjeve për konsolidimin e tij, padyshim që fondamenti kryesor është qëndrueshmëria e financave publike e reflektuar në parametrat e borxhit publik, deficitit fiskal, balancës primare, balancës korrente, etj.

Viti 2017 ishte një vit specifik në disa aspekte:

- Ishte i pari vit buxhetor, buxheti i të cilit programohej dhe ekzekutohej tashmë nën ombrellën e një seti rregullash fiskalë, që u përfshinë në amendimin që iu bë ligjit organik të buxhetit në qershor 2016, rregulla fiskalë, që konsistojnë si më poshtë:

- detyrimin ligjor të çdo qeverie për të ulur borxhin publik çdo vit buxhetor derisa ai të zbrësë dhe të qëndrojë në nivelin 45% të prodhimit të brendshëm bruto; ankorimin e parashikimeve makroekonomike me ato të Fondit Monetar Ndërkombëtar; përcaktimin e ankorave mbi shëndetshmërinë e strukturës së buxhetit lidhur me raportimin e shpenzimeve kapitale përkundrejt atyre korrente apo përkundrejt deficitit ose, siç njihet ndryshe, si rregulli i artë i buxhetit; përcaktimin e një limiti total të peshës që mund të kenë pagesat vjetore nga buxheti për PPP-të ose koncesionet; përcaktimin e ankorave kufizuese për sa i takon ekzekutimit të shpenzimeve buxhetore, deficitit buxhetor gjatë viteve elektorale dhe një sërë rregullash me parime të tjera fiskale.

Nga ana tjetër, sikurse e përmenda, viti 2017 ishte vit elektorale parlamentar dhe pati edhe një specifikë tjetër, atë të qeverisë së përkohshme teknike. Pra, të gjitha këto e bënë vitin 2017 të ishte një test real për financat publike dhe perspektivën e qëndrueshmërisë së tyre në vijim.

Përpara se të paraqes një rezymë të parametrave kryesorë të qëndrueshmërisë së financave publike, dua të ndalem në gjetjet paraprake të vlerësimit të auditit për sa i përket aspektit të forcimit të financave publike.

Përpjekjet madhore dhe intensive të kësaj qeverie dhe të Ministrisë së Financave në veçanti, për të përmirësuar qenësisht financat publike, me qëllim për të vendosur standarde të reja në menaxhimin e financave publike në vijimësi, janë të pamohueshme, po të krahasojmë pikën në të cilën ato ishin katër vjet më parë. Tani nuk flasim më për shlyerje detyrimesh të prapambetura, por për zerimin e tyre dhe tendenca në ulje është shumë domethënëse.

Jemi shumë afër zbatimit të plotë të një sistemi të planifikimit dhe kontrollit automatik të shpenzimeve publike, që jo vetëm ka ulur dhe do të ulë ndjeshëm parregullsitë, por ka shtuar presionin për të rritur efektivitetin e përdorimit të parave të tatimpaguesve, kjo edhe falë bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, si dy institucione, që, në themel të punës së tyre dhe misionit të tyre të përditshëm, kanë interesin e përbashkët publik të vendit.

Një pjesë e madhe e gjetjeve, sidomos ato sistemike, janë identifikuar dhe trajtuar në reformën e financave publike, që po zbatohet në mbështetje të plotë nga partnerët tanë ndërkombëtarë, si: BE-ja, FMN-ja dhe Banka Botërore.

Unë shpreh besimin se ky bashkëpunim, në funksion edhe të transparencës me parlamentin dhe publikun, ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme, që do të forcohet më tej gjatë procesit të integritit, ku reforma e financave publike është një nga shtyllat kryesore të bisedimeve për anëtarësim.

Besoj se në vijim do të kem rastin të ndalem në detaje te gjetjet dhe rekomandimet e raportit.

Për t'iu rikthyer ecurisë së treguesve kryesorë makroekonomikë, të përlogaritur dhe të konfirmuar me përgjegjshmëri nga stafi teknik i Ministrisë së Financave, dhe nga pasqyrat (i keni edhe në prezantimin elektronik) e sistemit informatik financiar qeveritar, ku unë i kam sjellë *print screen* (i kam printuar ashtu siç ekrani i sistemit informatik financiar qeveritar nxjerr deficitin buxhetor, pra deficitin në bazë të të ardhurave dhe të shpenzimeve të bëra nga qeveria e përgjithshme me këtë shifër të konfirmuar më së miri në përputhshmëri të plotë me ligjin, me furnizimin që i bën Thesari dhe sistemi njëri-tjetrit, me detyrimin ligjor që parlamenti i ka vendosur qeverisë dhe me tagrin ligjor që parlamenti dhe ligji më kanë dhënë për sa i përket zbatimit të buxhetit, si ministër i Financave), gjatë vitit 2017 treguesi i borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto, në momentin e programimit të buxhetit për vitin 2017, targetonte

një reduktim prej rreth 2 pikë përqindje në përputhje të plotë, në germë dhe në frymë, me rregullin fiskal që përmenda pak më lart.

Referuar statistikave faktike, rezulton se borxhi publik përgjatë vitit 2017 është reduktuar me 2,2 pikë përqindje nga niveli që regjistronte në vitin 2016, përkatësisht nga 72,3% e prodhimit të brendshëm bruto, ai ra në 70,1%. Kolona e buxhetit, pra ja ku e kemi, fakt i vitit 2017, e konfirmon qoftë deficitin, qoftë në konsekuencë borxhin publik.

Reduktimi është edhe më i lartë nëse i referohemi konceptit neto të borxhit publik, domethënë borxhi publik i zhveshur nga stoku/gjendja e aseteve likuide në TSA (llogaria e vetme e thesarit), që nuk cenon në asnjë rast nivelin e borxhit publik, përkundrazi janë domosdoshmëri për optimizimin e tij dhe ekzekutimit të buxhetit nga viti në vit, pra mbajtja e likuiditeteve.

Si çdo shtëpi, në ditën e fundit të vitit, ka në arkën e saj likuiditete për të përballuar janarin derisa të marrë rrogën e parë, ky është edhe koncepti i TSA-së, pra i llogarisë së qeverisë, që e krahasova me shtëpinë e çdo shqiptari.

Besoj se çdokush, që e lexon në mënyrë profesionale këtë parametër kyç të financave publike, e kupton domethënien e reduktimit prej 2 pikë përqindje në një vit të vetëm, sidomos në një vit elektorale. Nuk ka ndodhur kurrë më parë, pasi në çdo vit elektorale shpërbëheshin financat publike në atë farë feje që do të duheshin dy apo tre vjet të tjerë për t'i sistemuar.

Ndër të tjera, para pak ditësh në realizimin e një transaksioni shumë të suksesshëm në tregjet ndërkombëtare për emetimin e eurobondit dhe në finale besimi i investitorëve të huaj është një certifikim tejet i rëndësishëm dhe domethënës për qëndrueshmërinë e financave publike të Shqipërisë. Madje edhe të gjitha shifrat që ne përmendim sot këtu janë skanuar dhe analizuar në detaje, imtësisht, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga investitorët.

Deficiti i përgjithshëm fiskal për vitin 2017 targetohej që në fillim në nivelin 2% të prodhimit të brendshëm bruto, niveli më i ulët që është targetuar ndonjëherë gjatë dy dekadave, ndërsa niveli i tij faktik rezultoi, siç thuhet edhe në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në 1,99% të prodhimit të brendshëm bruto, pra 31 miliardë. Po kështu, edhe ekzekutimi i deficitit përgjatë vitit ishte: u targetua një balancë pozitive primare, pra një suficit primar. Çfarë do të thotë kjo? Qeveria nuk krijoi borxh të ri, përkundrazi, adresoi borxhin e trashëguar.

U targetua një balancë korrente fiskale pozitive, pra pati shpenzime kapitale më të larta sesa niveli i deficitit fiskal, në përputhje me rregullin fiskal të shkruar në ligjin organik të buxhetit, pra në ligjin që është platforma bazë e menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rezultati, balanca korrente fiskale ishte pozitive; shpenzimet kapitale faktike rezultuan në nivelin 4,4%, ndërsa nëse përfshijmë këtu edhe pjesën e investimeve të sektorit të energjisë të financuara nga buxheti, investimet publike faktike arrijnë në 5% të prodhimit të brendshëm bruto, që do të thotë se balanca korrente fiskale është mbi 3% të prodhimit të brendshëm bruto.

U realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi refinancimin e borxhit ekzistues, plotësimin e nevojave për likuiditet, si dhe financimin e deficitit të planifikuar përkatësisht në nivelin 79% e brendshme dhe 131% e huaja përkundrejt planit vjetor. Gjithashtu, u realizuan me sukses objektivat e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit gjatë vitit 2017 si në kuadër të optimizimit të raporteve ndërmjet kostove dhe rreziqeve, ashtu edhe në kuadër të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Gjatë vitit 2017 jo vetëm kostot për njësi, por edhe kostot e përgjithshme të huamarrjes, u ulën ndjeshëm krahasuar me vitin e mëparshëm. Vlen të theksohet rënia e shpenzimeve për interesat e borxhit shtetëror me rreth 4,4 miliardë lekë, krahasuar me vitin e kaluar.

Për sa u takon zhvillimeve kryesore në të ardhurat e buxhetit të vitit 2017, paketa fiskale në tërësinë e saj ka synuar përgjithësisht korrektime në elemente të veçanta tatimesh dhe taksash, si: akcizat, taksat kombëtare apo tarifatat doganore.

Qëllimi i paketës fiskale të vitit 2017 lidhet me thjeshtësimin e procedurave dhe mbështetjen e biznesit dhe sektorëve të ndryshëm prioritarë të ekonomisë, duke synuar nxitjen e rritjes ekonomike, të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore të vitit 2017, arritën në 430,4 miliardë lekë, me një realizim ndaj planit vjetor 98,6%, duke shënuar një rritje 5,7% ose 23,4 miliardë lekë më shumë se viti paraardhës.

Rritja me 0,1% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit në raport me prodhimin e brendshme bruto për vitin 2017 është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kryesisht, kjo rritje vjen nga përmirësimi në administrimin e taksave. Gjithashtu impakt pozitiv në rritjen e të ardhurave, sollën edhe masat e vazhdueshme për uljen e informalitetit në ekonomi.

Në zëra specifike, rezultoi se tatimi mbi vlerën e shtuar, u aplikua një shkallë e reduktuar në masën 6% e TVSH-së për sektorin e turizmit, me qëllim zhvillimin dhe nxitjen e mëtejshme, si dhe rritjen e konkurrencës me vendet fqinje.

Renta minerare

Mbështetja e industrisë minerare dhe aplikimi i lehtësirave fiskale nga qeveria ishte një stimul i rëndësishëm për zhvillimin e industrisë përpunuese në vend. Reduktimi i rentës minerare për mineralet metalore, e destinuar për përpunim brenda vendit, ishte një faktor pozitiv që mbështeti rritjen e vlerës së produkteve të prodhimit vendas. Praktikisht sot kemi një situatë ku industria e përpunimit ka kapur nivelet e saj më të larta historike.

Taksa e automjeteve të luksit shënoi uljen e kufirit të vlerës së automjeteve, që konsiderohen mjete luksi, nga 7 milionë lekë në 5 milionë lekë, me një efekt të kënaqshëm për vitin 2018.

Tarifa për masonët

Reduktimi i tarifës për fasonët nga 2%, 6%, 10% dhe 15% në masën 0%, me qëllimin për të krijuar një klimë më të favorshme për këtë industri, sollti edhe rritjen e eksportit dhe konkurrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare.

Heqja e tarifës nga 2% në 0% të produktit koks dhe gjysmë koks nga qymyrguri, e cila përdoret për procese teknologjike në furra pasurimi mineralesh, në funksion të industrinë prodhuese, favorizoi industrinë prodhuese e përpunuese në vend, duke ulur ndjeshëm kostot dhe duke nxitur prodhimin në vend dhe eksportin në tregjet ndërkombëtare.

Për sa i takon performancës së zërave të shpenzimeve buxhetore në tërësi, buxheti i vitit 2017 ka financuar 127 programe buxhetore dhe ka synuar realizimin e 1347 produkteve të 11 ministrive të linjës dhe fondeve speciale. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve. U menaxhua me suksese dhe ristrukturimi i ministrive dhe i agjencive në gjysmën e dytë të vitit.

Në vija të përgjithshme, është evidentuar një performancë e kënaqshme e nivelit të realizimit të produkteve buxhetore nga ministrinë të linjës. Nga 1347 produkte të parashikuara për vitin 2017, janë realizuar plotësisht dhe pjesërisht rreth 1283 produkte ose 95,3% e tyre.

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2017 arritën në nivelin 461,4 miliardë lekë, me një realizim në masën 98,7%, sipas planit të buxhetit fillestar dhe 97,3% të planit vjetor, sipas aktit normativ nr. 3, datë 06.11.2017 (planit i rishikuar).

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale kanë shënuar një realizim respektivisht në masën rreth 98 % dhe 92 % të planit fillestar, si dhe 97,2 % dhe rreth 93,4% të planit të rishikuar 2017, me një deficit faktik prej rreth 30,9 miliardë lekësh, që e bën deficitin buxhetor, ashtu siç ishte referuar dhe ligjshmërisht Kontrolli i Lartë i Shtetit 1, 99% e prodhimit të brendshëm bruto.

Investimet kryesore të financuara me buxhetin e vitit 2017 sipas sektorëve:

Arsimi

U realizua rimbursimi i teksteve shkollore falas për rreth 100 mijë nxënës të arsimit parauniversitar me një fond prej 349,8 milionë lekësh, nga të cilat 82, 815 nxënës të arsimit bazë në vlerën 268,9 milionë lekësh dhe 16, 400 nxënës të arsimit të mesëm të përgjithshëm në vlerën 80,9 milion lekë.

U realizua financimi për rikonstruksionin, rindërtimin e 64 objekteve arsimore, kontratave të miratuara me vendimin e komitetit për zhvillimin e rajoneve, nga të cilat në arsimin bazë u financuan 44 objekte arsimore dhe kontrata me vlerë të plotë në shumën 2,9 miliardë lekë dhe me vlerë financimi në shumën prej 1,2 miliardë lekë për vitin 2017.

Në arsimin e mesëm të përgjithshëm u financuan 18 objekte arsimore dhe kontrata me vlerë të plotë në shumën 1,44 miliardë lekë dhe me vlerë financimi në shumën prej rreth 723 milionë lekë për vitin 2017.

U mbështetën financiarisht 25 federata sportive dhe sportistët me rezultatet e larta.

Arsimi profesional dhe punësimi

8 shkolla dhe 20 reparte të bazave prodhuese u rikostruktuan, u ndërtuan të reja dhe u pajisën me makineri e pajisje. Fondet e nxitjes së punësimit janë pesëfishuar në krahasim me 5 vjet më parë, duke arritur vlerën e 490 milionë lekë në vitin 2017. Me këtë financim është rritur numri i punëkërkuesve të papunë që trajtohen nga skemat e nxitjes së punësimit ka një rritje të konsiderueshme në mbi 7000 në vitin 2017.

Janë zgjeruar fushat e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit deri në vitin 2017 në fusha të tilla si: industria prodhuese, industria e turizmit, teknologjia e informacionit, aktivitete të lidhura me bujqësinë, me blegtorinë, dhe industrinë e tjera prioritare.

Përfunduan disa projekte në fushën e arsimit profesional, si: rikonstruksioni i ndërtesës dhe bazës prodhuese të shkollës “Ali Myftiu”, Elbasan, rikonstruksion dhe përshtatje e bazës prodhuese të shkollës së mesme “Kristo Isak“, ndërtimi i ndërtesës së shkollës kombëtare të agrobiznesit “Charles telefort” dhe rikonstruksioni i ndërtesës së shkollës teknologjike “Hamdi Bushati”, Shkodër.

Arriti në 36% niveli i nxënësve, të cilët vazhdojnë arsimin e mesëm në drejtimin e arsimit profesional me një rritje me 25%, në krahasim me 2016, të numrit të nxënësve të regjistruar; 19 000 nxënës studiojnë në shkollat e arsimit profesional; 15 711 persona u certifikuan në qendrat e formimit profesional, nga të cilët 8 040 femra; 13 000 nxënës morën kompensim për tekstet.

Shëndetësia

Gjatë vitit 2017 përfunduan disa projekte të rëndësishme si: rikonstruksioni i urgjencës së spitalit rajonal Berat; rikonstruksion i godinës së reanimacionit në Spitalin e Pediatriisë Vlorë; rikonstruksioni i ambienteve të reanimacionit të Spitalit Shkodër; rikonstruksioni dhe pajisja e Qendrës Shëndetësore në Bashkinë Kamëz dhe furnizimin me pajisje mjekësore dhe hotelerie për godinën e maternitetit të spitalit të Sarandës.

U zgjerua programi i kontrollit bazë për grupmoshat 35-70 vjeç duke i dhënë këtë mundësi 1,260 mijë personave rezidentë në Shqipëri.

600 mijë vetë të pasiguruar për të parë filluan të përfitojnë nga rimbursimi i barnave, pra një nga politikat thellësisht sociale dhe solidare që kjo qeveri avancoi në vitin 2017.

Shpenzimet publike të shëndetësisë për çdo banor u rritën nga 12,295 lekë në 2013 në 16,260 lekë në 2017.

Shërbimi i Urgjencës Mjekësore u rithemelua duke përqendruar komandën dhe dekoncentruar vendndodhjen e flotës së autoambulancave në territor.

Në vitin 2017-ën: u shtuan 20 autoambulanca dhe 1 helikopter mjekësor; u hapën 25 qendra shëndetësore 24/7, në mbështetje në sezonit turistik dhe funksionoi urgjenca kardiale dhe ajo vaskulare-cerebrale për 24 orë në 7 ditë të javës.

Infrastruktura

Përfunduan disa kontrata të rëndësishme investimesh në infrastrukturë:

Ndërtim rruga e Porto Romanos, Durrës, loti 1,

Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës, Komuna e Parisit - Shkolla Teknologjike

Ndërtim i rrugës së Arbërit Dalja e urës së Vashës Bulqizë, loti 2 (shtesë punimesh)

Ndërtim rruga Lushnjë – Berat, loti 2,

Ndërtim rruga Lushnjë- Berat, loti 3

Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës segmenti Komuna e Parisit - rruga e Kavajës

Ndërtimi i rrugës bajpas Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 7.

Ndërtimi i rrugës Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan

Filloi projekti i Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore 2015-2020, afërsisht 130 milionë dollarë, bashkëfinancimi i qeverisë shqiptare dhe Bankës Botërore, koncepti i së cilit ishte ai me bazë-performance.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

U realizuan mbi 10 projekte investimesh për argjinaturat e lumenjve dhe mbrojtjen prej tyre, ku përmendim: kanalin Peqin – Kavajë, lumi Shkumbin; argjinatura e lumit Drin i Zi, fshati Potgorcë; mbrojtja nga lumi i Vjosës në krahun e djathtë, zona Pishporo; argjinatura mbrojtëse nga lumi Shkumbin, lumi Devoll, 100 metër poshtë urës së Trenit; Dunavec, grykëderdhja e përroit, Voskop; skema ujitëse e fushës së Milotit, Mamurrasit dhe Drojës; argjinatura e lumit Mat, krahu i djathtë i rrjedhës; Tale dhe krahu i majtë, zona Alk Kurbin; mbrojtja nga lumi Kir, Bleran; sistemi i përrrenjve malorë mbi KUL, Kurbin; riparim porta mbi KUL Gjorm, e cila shërben edhe si kanal ujitës; mbi KUL portat Kashnjet, mbi Kulluesin K-3 Mamurras-hidrovari Drojë dhe argjinatura Darragjat, lumi Buna, Shkodër.

Përfunduan projektet me financim të huaj, granti francez, projekti për biodiversitetin dhe mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural, IPARD.

Zhvillimi Rural

Skemat mbështetëse të fermerëve livruan një fond prej 946 milionë lekësh, nga të cilat 202,3 milionë lekë për luftimin e insekteve të ullirit në 6 qarqe: Elbasan, Fier, Vlorë, Tiranë, Lezhë dhe Berat me një sipërfaqe prej 5599,57 hektarësh, 335,8 milionë lekë për dëmshpërblimin e fermerëve me lopë të dëmtuara nga dermatoza nodulare, si dhe për blerjen e 1912 krerë lopëve për fermerët e dëmtuar.

Mbrojtja Sociale dhe Strehimi

U trajtua me ndihmë ekonomike të plotë dhe jo më të pjesshme, sipas numrit të individëve, çdo familje, ku 32441 familje paguhen dyfish ose trefish më shumë, krahasuar me skemën e vjetër; u trajtuan me ndihmë ekonomike 52443 familje përfituese; u rrit nga 3% në 6% fondi për pushtetin vendor për të trajtuar rastet që nuk mund të përfitojnë nga sistemi elektronik, si dhe u shpërblyen 80000 familje në nevojë për festat e fundvitit, pjesë e paketës së solidaritetit.

Aftësia e Kufizuar

U trajtuan me pagesën e aftësisë së kufizuar 159621 persona nga disa kategori: invalidë të verbër, përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar; paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar, si dhe personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar. Përfitimet u indeksuan me nivelin e inflacionit. Përfituan pagesa të plota dhe në kohë 66557 persona me aftësi të kufizuar, 18311 kujdestarë të tyre, si dhe 71528 invalidë pune, ndryshe nga praktika e qeverisjes së kaluar, që, po ta mbani mend, i lanë pa bukë dhe i mbajtën 44 milionë dollarë nga e drejta që kjo kategori kishte për të përfituar. Edhe për vitin 2017 u riaplikua praktika e ndjekur në katër vjet qeverisje, ku personat me aftësi të kufizuara përfituan bonusin e shpërblimit të fundvitit.

Strehimi

Në programin e strehimit u realizuan 3 projekte të rëndësishme: përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian në bashkitë e ndryshme të vendit, si: Shijak, Elbasan, Fier, Rrogozhinë, Krujë, Librazhd, Lushnjë, Rrëshen dhe Pogradec; rikonstrukcioni i godinave në pronësi të njërive të qeverisjes vendore për strehim social për bashkitë Patos dhe Koplik, për projektin “Banesa me qëllim social, për fazën e dytë, me 126 apartamente, u lidhen kontratat me të gjithë përfituesit.

Turizmi dhe mjedisi

TVSH-ja për turizmin u ul në 6% për vitin 2017, u rehabilitua plotësisht vendepozitimi ekzistues i mbetjeve në Elbasan, u ndërtua një landfill i ri modern bashkë me impiantin e parë për prodhimin e energjisë elektrike dhe termike, si dhe përparuan punimet për ndërtimin e impiantit të dytë në vend për prodhimin e energjisë nga mbetjet në qarkun e Fierit;

Kultura

U realizuan disa rikonstrukcione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor për institucionet e artit dhe kulturës, nëpërmjet mirëmbajtjes dhe restaurimit të 155 monumenteve në

të gjithë vendin; përfundimit të rikonstruksionit të godinës së teatrit "Migjeni"; vijimin e punimeve për rikonstruksionin e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, që besoj se përfundon në vjeshtë të vitit 2019, një vit para afatit, si dhe vijimin e punimeve për Qendrën Kombëtare Kulturore Skena e Re, e cila përfundoi në vitin 2018.

Buxheti Vendor i vitit 2016, zbatimi i reformës administrativo-territoriale:

Reformimi i financave vendore kulmoi me miratimin e ligjit "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në vitin 2017. Përmes buxhetit të vitit 2017 u konsoliduan efektet e reformës. Buxheti vendor i vitit 2017 në tërësi është 7% më i lartë se ai i vitit 2016. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2017 u mblodhën rreth 23% më shumë sesa në vitin 2016. Shpenzimet për investime në qeverisjen vendore në vitin 2017 janë 15% më të larta sesa në vitin 2016. U investuan 380 milionë lekë për rehabilitimin e skemave ujitëse sipas bashkive, me qëllim mirëfunksionimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit, me impakt në zhvillimin rajonal. Nëpërmjet implementimit të funksioneve të transferuara, u akordua fondi në vlerën 400 milionë lekë për rritjen e pagave për çdo funksion të transferuar nga pushteti qendror në atë vendor; nga 11000 kilometra kanale kulluese të transferuara në qeverisjen vendore, në vitin 2016, vetëm 11% e tyre, ose 121 kilometra, ishin pastruar, ndërkohë, në fund të vitit 2017, pastrimi i këtyre kanaleve u trefishua në 400 kilometra ose 36% e rrjetit kullues. Po ashtu, sistemi i ujitjes në vitin 2017 është mbi tri herë më i përmirësuar sesa në vitin 2015, me mbi 100000 hektarë tokë, më shumë nën ujë. U akorduan fondet e domosdoshme për investime për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe funksionimin e këtij shërbimi në 12 bashki.

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2017

Gjatë vitit 2017 buxheti i shtetit u ndryshua nëpërmjet dy akteve normative:

Së pari, nga akti normativ nr. 2, datë 16.08.2017 "Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017". Hartimi i këtij akti normativ u bazua në performancën makrofiskale dhe buxhetore të 6-mujorit të parë të vitit 2017, si dhe në parashikimin e pritshëm të treguesve deri në fund të vitit buxhetor 2017. Ai siguroi ruajtjen e parametrave kryesorë të buxhetit fillestar të vitit 2017, për sa kohë që deficitin buxhetor mbetet i pandryshuar. Synimet kryesore që kërkonte të realizonte dhe realizoi qeveria nëpërmjet këtij akti normativ konsistuan kryesisht në përshpejtimin e projekteve të investimeve publike me impakt të qenësishëm pozitiv në rritjen ekonomike, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të saj për vitin 2017, si dhe

rritjen e huamarrjes neto nga sektori energjetik, për të mundësuar përmbushjen e nevojës për energji elektrike deri në fund të vitit 2017, duke konsideruar situatën e vështirë klimaterike, që karakterizoi gjysmën e parë të vitit 2017.

Së dyti, nga akti normativ nr. 3, datë 06.11.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, i ndryshuar””. Formimi i qeverisë së re në shtator të vitit 2017, dalë pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 25 qershorit, kulmoi me riorganizimin e Këshillit të Ministrave dhe për rrjedhojë ristrukturimin e përbërjes së tij. Ky akt i dytë normativ i buxhetit në vitin 2017 mundësoi përmbushjen e disa angazhimeve të qeverisë, të tilla, si: institucionalizimin dhe zbatimin e plotë në terma të ligjit të buxhetit, të fushave të reja të përgjegjësive për çdo ministri linje, nëpërmjet reflektimit të ndryshimeve organike dhe buxhetore, pas miratimit të qeverisë së re; ligjërimin e akomodimit organik dhe buxhetor të strukturave të reja të vetingut, përkatësisht të tri komisioneve respektive të ngritura për këtë qëllim; përfshirjen në termat e aktit normativ nr.3, të një propozimi përjashtimor për vitin 2017, lidhur me kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, me fokus shlyerjen 100 % të këstit të 8-të dhe të fundit të kategorisë parësore të përfituesve të gjallë. Këtë vit shtuam këstin e 9-të, sapo kemi filluar shlyerjen e tij, deri në fund të vitit 2018, dhe përfundojmë të gjithë shlyerjen 100% të këstit të 8-të dhe të fundit të kategorisë parësore.

Shlyerjen e detyrimeve kontraktuale të prapambetura të institucioneve buxhetore deri në fund të vitit 2017, me fokus kryesor pagesën e TVSH-së dhe kostos lokale për sektorin e infrastrukturës rrugore dhe atë të ujësjellës-kanalizimeve nëpërmjet akordimit të fondeve të dedikuara për të shlyer një pjesë të mirë të tyre.

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e mësipërme nuk cenuan nivelin e planifikuar të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke e ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme, duke garantuar objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

Kjo ishte një pasqyrë e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e buxhetit 2017, e zbatimit të tij dhe produkteve që mundësoi ky buxhet për qytetarët.

Sigurisht që gjatë diskutimit të mëtejshëm besoj do të kemi mundësi ta kemi të fokusuar në *Power-Point*. Unë do të ndaj me komisionin, në mënyrë që komisioni të jetë shumë i qartë se çfarë janë këto tabela. Këto janë tabela të sistemit informatik financiar të qeverisë, të mbështetura në këtë kolonë, e cila është kolona kryesore e thesarit, që i referohet deficitit faktit, i

cili është në përputhje të plotë me atë detyrë që ka vendosur parlamenti. Për të furnizuar dhe atë debat, besoj të promovuar nga lloj-lloj mendjesh, midis të ashtuquajturave diferenca, ja ku e keni buxhetin faktik, ja ku e keni deficitin faktik dhe do t'ju sjell në vëmendje këtë tabelë nga sistemi informatik i qeverisë, pra tabelën fiskale që prodhon thesari, pastaj do të kaloj vit më vit: tabela fiskale e thesarit 2016, e vitit 2015 e me radhë, dhe do të zbresim te viti 2011 për të parë që sistemi informatik qeveritar, i bërë si i tillë për të ndihmuar thesarin, është i njëjti. Ja dhe kolona faktike e vitit 2011, e referuar në bazë të ligjit, dhe kolona e planit, që janë stisur artificialisht me demek diferenca. Ja ku është në vitin 2011 deficiti në bazë të ligjit dhe kolona që u referohet planeve, që do të bëhet efektive më 1 janar të vitit 2019, kur sistemi informatik financiar qeveritar të lidhet me AFMIS-in, që do të jetë sistemi ku do të bëjmë të mundur ndjekjen në mënyrë të detajuar të planit dhe të faktit. Kolona e deficitit faktik, që është detyrim ligjor, është kjo. Ja ku është Ridvan Bode i përputhur 100 % me ligjin. Ja ku është Shkëlqim Cani i përputhur tërësisht me ligjin, pra mora vitin 2015. Kolona e planit ndryshon, sepse nuk është kolonë që verifikon deficitin faktik, pra tabela e Canit. Ja ku është edhe tabela e vitit 2017, deficiti faktik dhe të dhënat e planit.

Sigurisht që më duhet të ndaj me ju faktin se është hera e parë që KLSH-ja ka akses mbi sistemin informatik financiar të qeverisë, në mënyrë që të dyja institucionet, që kanë qëllim transparencën e financave publike, të jenë në gjendje të gjykojnë më drejtë për të gjitha ato rekomandime që i jep me të drejtë KLSH-ja.

Jua solla këto tabela për t'ju thënë që në bashkëpunimin midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit ka nevojë që të dyja stafet të punojnë më shumë me njëri-tjetrin, në mënyrë që edhe KLSH-ja, në të drejtë dhe në detyrë të vet, të jetë në vazhdimësi më e familjarizuar me sistemin informatik financiar të qeverisë, që puna e përbashkët të bëhet në vazhdimësi të jetë më e lehtë.

Mua më vjen mirë, dhe e falënderoj Kontrollin e Lartë të Shtetit që i referohet ligjërishit plotësisht të kushtit ligjor që qeveria ka për deficitin, madje jo 2 %, sa i referohem unë, po 1, 99 %, detyrimi ligjor i qeverisë. Besoj se kemi shumë punë përpara së bashku që, sidomos me AFMIS-in, që do të fillojë më 1 janar, që gjithmonë edhe më shumë të kemi rekomandime për përmirësimin e financave publike. Ka shumë rekomandime të KLSH-së, që nga ato të hapjes së prokurimeve të palidhura me financimin, ndjekjen e detyrimeve të prapambetura, rekomandimet

për financat publike apo të planifikimit buxhetor në tërësi, që janë shumë të rëndësishme. Besoj se në vazhdimësi, me një punë të përbashkët, kemi mundësinë t'i përmirësojmë deri në zhdukjen e këtyre fenomeneve që e bëjnë, ka raste gangrenë, menaxhimin e financave publike.

Kam bërë një konkluzion të deficitit faktik, i cili është detyrimi ligjor i qeverisë, që, në fakt, vjen si konsekuencë e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike, që besoj se është një koncept shumë i rëndësishëm për ta kuptuar. Këto janë diferenca operative në bazë të planeve, të cilat, sigurisht, në të ardhmen me AFMIS-in do të jenë shumë më të sakta. Detyrimi ligjor është deficitit faktik, që është konsekuencë e të ardhurave dhe shpenzimeve. Këtu kam sjellë edhe udhëzimin nr. 23 të ministrit të Financave, i cili i referohet me të drejtë, në bazë të ligjit, tagrit që i jep ligji: “Për llogari të buxhetit të shtetit të vitit 2017, në pasqyrën vjetore të përgjithshme të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisë përfshihen të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në sistemin informatik financiar”, pra ajo kolona e deficitit që iu referova unë. Më vonë thotë: “Të gjitha shpenzimet publike të ndodhura, të dokumentuara, nga 01.01.2017 deri më 31.12.2017”. Pra, jemi shumë të qartë për këtë. Dua që të falënderoj për zemërsisht KLSH-në. Në eksperiencën time gati 3-vjeçare si ministër Financash kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer. Besoj se puna e përbashkët ka bërë të mundur që financat publike të përmirësohen dhe që konsolidimi fiskal të jetë në drejtimin e duhur, drejt një deficitit rekordi historik të ulët dhe trajektores ulëse të borxhit publik.

Dua ta mbyll (pastaj komisioni do të ketë pyetje), duke thënë që të dyja institucionet janë të vendosura të punojnë së bashku për përmirësimin e raportimeve buxhetore, në mënyrë që të bëjmë të mundur që në krye të një viti, kur të diskutojmë buxhetin e viteve 2018 dhe 2019, duke iu referuar edhe fillimit të punës më 1 janar 2019 me sistemin AFMIS, që do ta ndihmojë të dyja institucionet, të kemi mundësi që transparenca deri në detaje të jetë e mundur. Sigurisht që është detyrë e të dyja stafeve që të punojnë së bashku për kuptueshmërinë e detajuar të sistemit informatik financiar të qeverisë.

Këtu unë po e mbyll diskutimin tim dhe jam i gatshëm për pyetje apo diskutime të tjera, duke iu referuar interesit që ju do të keni në vazhdimësi.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Lati, do ta prezantoni ju opinionin, apo dikush tjetër?

Manjola Naço – Do ta prezantoj unë.

Erion Braçe – Urdhëroni! Keni një orë kohë në dispozicion.

Manjola Naço – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

I nderuar zoti Ministër,

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 154 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ka përgatitur dhe paraqet sot raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017, i cili është miratuar nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me vendimin nr. 155, datë 3. 10. 2018.

Fokusi kryesor është dhënia e opinionit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017.

Objektivi kryesor i gjithë punës audituese në funksion të përgatitjes së këtij raporti është të evidentojë dhe të analizojë problematikat në të tre komponentët e menaxhimit të sistemit buxhetor (programim, zbatim, monitorim), gërshetuar me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, si instrument bazë për garantimin e disiplinës fiskale.

Risi e këtij raportimi është se KLSH shprehet me opinionin e auditimit të zbatimit të buxhetit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe në mënyrë specifike ka respektuar kërkesat e standardit ndërkombëtar të auditimit të institucioneve supreme të auditimit, 1700, formulimi i opinionit dhe raportimi mbi pasqyrat financiare.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për dhënien e këtij opinionit, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se në disa zëra buxhetorë, përfshirë nivelin e deficitit dhe borxhin publik, ka devijime në drejtim të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me ligjin nr. 130\2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, i ndryshuar”, ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe ligjin “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror, garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Procesi i zbatimit të buxhetit të shtetit rezulton me thyerje të kontrolleve dhe masave parandaluese, deduktuese dhe korigjuese, që do të garantonin një disiplinim fiskal të sektorit publik. KLSH ka konstatuar që shumë nga masat dhe përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore, të hartuara me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, eliminimin e mundësive për mosraportimin në kohë të shpenzimeve dhe marrjen e angazhimeve

financiare pa fonde buxhetore, në bashkëpunim edhe me institucionet ndërkombëtare, kanë rezultuar joefikase dhe të pazbatuara.

Sjellim në vëmendje se opinioni i dhënë mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në financat publike për vitin 2017, paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk reflekton situatën reale të implementimit të kërkesave të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe niveli i strukturave të auditit të brendshëm mbetet larg standardeve të synuara nga përmirësimet ligjore të ndërmarra nga qeveria në fund të vitit 2015.

Treguesit e konsoliduar fiskal të buxhetit 2017.

Sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit për vitin 2017 janë realizuar në vlerën 430 492 milionë lekë ose 98,6% kundrejt planifikimit fillestar në ligjin nr. 130 të vitit 2016.

Sipas raportimit të Ministrisë së Financave, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2017 u realizuan në vlerën 461 410 milionë lekë ose 98,67% kundrejt planifikimit fillestar, duke reflektuar mosshpenzim të fondeve të planifikuara në masën 6 190 milionë lekë.

Po sipas Ministrisë së Financave, me aktin normativ nr. 3, datë, 06. 11. 2017, konstatojmë se niveli i shpenzimeve të riprogramuara nuk është realizuar në vlerën 12 690 milionë lekë. Arsyet e mosrealizimit të shpenzimeve janë mosrealizimi i të ardhurave në krahasim me planin, ecuria ekonomike dhe detyrimi për të mbajtur nivelin e deficitit nën 2% të produktit të përgjithshëm bruto.

Deficiti buxhetor i raportuar për vitin 2017 është realizuar në masën 30 919 milionë lekë ose 99,1% krahasuar me nivelin e parashikuar prej 31 200 milionë lekësh. Deficiti i raportuar rezulton të jetë sa 1,99% e PBB, çka në aspektin formal rezulton brenda limitit ligjor prej 2% të Produktit të Përgjithshëm Bruto.

KLSH, bazuar në auditimin e realizuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konstaton se niveli i deficitit është i nënvlerësuar si rezultat i shpenzimeve buxhetore vjetore të pa raportuara në periudhën respektive dhe kryerjes së riklasifikimeve në përgatitjen e treguesve fiskalë, të cilët kanë mëtuar vlerën e deficitit me burimet e financimit të tij.

KLSH konstaton se, sikurse edhe në vitet e kaluara, aftësia buxhetuese dhe menaxhuese e financave publike reflekton dobësi. Devijimet e shumta që kanë pësuar të ardhurat dhe shpenzimet, që nga faza fillestare e planifikimit të tyre, deri në fazën e realizimit faktik, si dhe

devijimet në mënyrën e mbulimit të financimit të deficitit buxhetor nga financimi i brendshëm në atë të huaj, tregojnë për këto dobësi.

Ndryshimet me aktet normative gjatë vitit buxhetor.

Akti normativ nr. 2, datë, 16. 08. 2017 dhe akti normativ nr. 3, datë 06. 11. 2017, shkaktuan mungesë të kredibilitetit të buxhetit dhe evidentuan nevojën për përmirësim të ndjeshëm të procesit të planifikimit buxhetor.

Procedurat e programit të investimeve paraqesin dobësi të përhapura.

Konstatohet se janë financuar projekte në ndryshim nga lista e investimeve të paraqitura në **PBA** dhe projektbuxhetin e vitit përkatës.

Referuar të dhënave të regjistruara në Sistemin Informativ Qendror, konstatohet se, në zbatim të ligjit nr. 130 të vitit 2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, janë çelur projekte investimi me financim të brendshëm në vlerën 5 095 milionë lekë, të cilat janë mbyllur më pas me aktin normativ nr. 3, datë 06. 11. 2017, fakt i cili tregon për një buxhetim të dobët dhe formal nga ana e ministrive të linjës. Konstatohen projekte investimi, të cilat janë çelur për herë të parë me miratimin e aktit normativ nr. 3, por, referuar kontratës së regjistruar në Sistemin Informativ Qendror, këto projekte investimi janë në të vërtetë kontrata në vazhdim nga vitet e kaluara. Kryesisht bëhet fjalë për projektet e FZHR-së në një vlerë të konstatuar prej 6530 milionë lekësh.

Aktet normative në fund të vitit u japin mundësi institucioneve të ndërmarrin angazhime buxhetore pas datës 15 tetor 2017, në kundërshtim me ligjin organik të buxhetit, të ndryshuar.

Nga analiza e urdhër-prokurimeve të regjistruara po në sistemin informatik të qeverisë, u konstatuan 206 prokurime në vlerë 6,3 miliardë lekë të ndërmarra pas datës 15. 10. 2017, në shkelje të nenit 51 të ligjit të buxhetit, pavarësisht se në nenin 2 të VKM-së nr. 807, datë 16. 11. 2016, “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore, mund të fillojnë dhe vazhdojnë vetëm ato projekte që janë pjesë e buxhetit 3-vjeçar.

Në kushtet kur nuk regjistrohet PBA-ja, në 90% të rasteve nuk mund të japim siguri nëse këto prokurime janë në përputhje me VKM-në apo në shkelje të ligjit të buxhetit. Rastet e cilësuar në raport kanë nevojë për një investigim të mëtejshëm, për të verifikuar nëse janë pjesë e planit buxhetor 3-vjeçar të miratuar.

Planifikimi optimist i të ardhurave ka lejuar një planifikim më të madh të shpenzimeve, brenda limitit të deficitit të vendosur me ligj.

Të ardhurat tatimore rezultuan në vlerën 398,629 milionë lekë, duke përbërë 93% të të ardhurave të buxhetit të shtetit prej 430,492 milionë lekësh. Të ardhurat nga tatimet, referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë realizuar në vlerën e 131,869 milionë lekë ose 93% në krahasim me planin përfundimtar.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore, për mbledhjen e të cilave është përgjegjëse DPT-ja, janë realizuar në vlerën 83 miliardë lekë ose 103% në krahasim me planin përfundimtar.

Të ardhurat nga TVSH-ja bruto, paraqitën një realizim prej 88,5% në krahasim me planin përfundimtar, ose 97,7% krahasuar me planin fillestar.

Mosrealizimi i të ardhurave, veçanërisht i atyre tatimore, ka ndikuar në rritjen e stokut të rimbursimit të TVSH-së për të shlyer dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Nga analiza e të dhënave konstatohet se kanë mbetur pa likuiduar, deri në datën 31.12.2017, kërkesa të miratuara në vlerën 11,422 milionë lekë (stoku i rimbursimit të TVSH-së). Megjithëse kjo shumë ka plotësuar kushtet ligjore për rimbursim dhe është certifikuar nga administrata tatimore, nuk rezulton e evidentuar në regjistrat e detyrimeve të DPT-së si angazhim i marë. Nga ana tjetër, janë konstatuar problematika në lidhje me skemën e rimbursimit të TVSH-së.

Thyerja e afateve dhe e radhës së pagesave në procesin e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Në 586 raste nga 901 kërkesa të trajtuara, kemi tejkalim të afateve të rimbursimit me një vlerë rimbursimi prej 11,171 milionë lekësh. Kjo vlerë përfaqëson 65% të kërkesave ose rreth 50% të vlerës totale të rimbursimit për vitin 2017. Ditët nga kërkesa në rimbursim shkojnë deri në 405.

Nëse do t'u referohemi likuidimeve të kryera gjatë vitit 2017, rezulton se pothuajse në të gjitha rastet e pagesave prej 13,774 milionë lekësh, kemi thyerje të radhës së rimbursimit, nisur jo vetëm prej afateve të parashikuara ligjore, por edhe datës së miratimit të rimbursimit pas plotësimit të kushteve procedurale të administratës tatimore.

Në këndvështrimin e KLSH-së, risk të lartë paraqet procesi i trajtimit nga ana e administratës tatimore të rasteve të rimbursimit të TVSH-së për kontratat koncensionare në

fushën e energjisë, ku nga ana e administratës certifikohen dhe paguhet TVSH-ja për vlera punimesh që tejkalojnë vlerën e kontraktuar nga shteti shqiptar në kontratat koncensionare.

Të ardhurat nga doganat, referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, janë realizuar në vlerën 159,099 milionë lekë ose në masën 100,9%, me një tejkalim prej 1,370 milionë lekësh.

Nga auditimet me administratën doganore kanë rezultuar veprime e mosveprime në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit doganor, të cilat kanë sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit me një total prej 2,138 milionë lekësh.

Të ardhurat nga pushteti vendor janë realizuar për 18,447 milionë lekë, kundrejt 15,400 milionë lekëve të planifikuara sipas planit fillestar, ose janë realizuar në masën 119,8%. Në krahasim me planin përfundimtar, këto të ardhura janë realizuar në masën 88%.

Të ardhurat jotatimore zënë 4,8% të të ardhurave gjithsej të buxhetit të shtetit ose 20,778 milionë lekë, kundrejt 24,400 milionë lekëve të planifikuara në këtë zë buxhetor.

Fitimi neto i Bankës së Shqipërisë për vitin 2016, i derdhur në buxhetin e vitit 2017, ka rezultuar në vlerën 908 milionë lekë dhe është derdhur në buxhetin e shtetit, si dhe është raportuar në këtë zë. Trendi i realizimit të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë ka ardhur çdo vit në ulje.

Është konstatuar së kostoja e kontratave SWAP, instrumenti i përdorur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin e likuiditetit në valutë, vazhdon të mos raportohet si zë më vete shpenzimesh, por kontabilizohet në formën e një të ardhure negative, duke denaturuar llojin dhe koston e këtyre transaksioneve. Pavarësisht se nga KLSH-ja është kërkuar prezantimi i drejtë i këtij shpenzimi si kosto borxhi, edhe për këtë vit konstatohet që kostoja e SWAP-it, në shumën 567 milionë lekë, nuk planifikohet dhe nuk raportohet si shpenzim buxhetor faktik. Gjithashtu, është konstatuar që një pjesë e të ardhurave nga privatizimi, e krijuar gjatë vitit 2017, nuk ka shkuar për kryerjen e investimeve kapitale sipas kufizimeve të vendosura në ligjin për buxhetin, por kanë financuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt privatizimin, në shumën 90 milionë lekë ose 22% e këtyre të ardhurave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar treguesve fiskalë të konsoliduar, konstatohet se shpenzimet e buxhetit faktik janë në vlerën 461,410 milionë lekë dhe përbëhen nga shpenzimet korrente, që zënë rreth 82,9%

të shpenzimeve faktike. Konstatohet se shpenzimet korrente janë realizuar në vlerën 382,287 milionë lekë, nga 390,169 milionë lekë të planifikuara sipas ligjit nr. 130/2016, ose janë realizuar në masën 98,2%, me një mosrealizim prej 7,882 milionë lekësh kundrejt planit.

Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 68,485 milionë lekë nga 74,431 milionë lekë të planifikuara sipas buxhetit fillestar, ose janë realizuar në masën 92%. Në një analizë më të detajuar, në terma të realizimit mujor të shpenzimeve për investime, rezulton se pjesa më e madhe e investimeve kapitale, ose 24,8%, është përqendruar në muajin dhjetor.

Shpenzimet kapitale përfshijnë edhe letër-kreditë në mbyllje të vitit ushtrimor, të cilat, megjithëse në mënyrë më të moderuar se vitet e tjera, edhe për këtë vit janë përdorur për mosdjegien e fondeve, duke rritur zërin e investime kapitale në vlerën 211 milionë lekë.

Janë angazhuar fonde të planifikuara si investime për kryerjen e shpenzimeve operative, si: shpenzime për paga dhe sigurime, shpenzime postare, të telefonisë celulare e të tjerë, në vlerën 1,536 milionë lekë. Kjo problematikë konstatohet veçanërisht në zërin e shpenzimeve kapitale me financim të huaj, ku pavarësisht natyrës së shpenzimit, raportimi buxhetohet automatikisht si shpenzim kapital.

Lidhur me realizimin e shpenzimeve të buxhetit të vitit 2017, ndërmjet të tjerave kemi konstatuar se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk raportohen dhe nuk deklarohen si shpenzim, në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Efekti i pagesave të kryera nga buxheti i shtetit për vitin 2017, për largim të padrejtë të punonjësve nga puna, vlerësohet rreth 2 miliardë lekë, raportuar si shpenzime operative, si dhe për vendimet e tjera gjyqësore rreth 1 miliard lekë. Në të njëjtën linjë, edhe për vendimet gjyqësore me objekt çështjet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut u konstatua se vendimet gjyqësore të miratuara për pagesë nga viti 2016 rezultonin sipas detyrimeve të aparatit të Ministrisë së Financave të pakontabilizuara me rreth 500 milionë lekë. Për vendime gjyqësore, të cilat nuk janë autorizuar për pagesë KLSH-ja e ka të pamundur të vlerësojë efektin duke qenë se ato nuk regjistrohen në *database*-in e vendimeve gjyqësore dhe as në kontabilitet. Lidhur me këto shpenzime KLSH-ja parashtron kërkesën për futjen e tyre në procesin e ekzekutimit buxhetor, duke marrë parasysh efektin e mundshëm në vitet e ardhshme në formën e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe trajtimin e plotë të përgjegjësisë në lidhje me vendimmarrjen

me kostot financiare të nëpunësve publikë në të njëjtën linjë me kërkesën e vazhdueshme për hartimin dhe miratimin e ligjit “Për përgjegjësinë materiale”.

Detyrimet e prapambetura vijojnë të mbeten problem për financat publike. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të viteve të kaluara, duke mos prodhuar rritje reale të buxhetit, por pagesa për shërbime dhe të mira që janë realizuar në vitet e mëparshme buxhetore. KLSH-ja konstatoi se gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2017 janë realizuar 6,857 pagesa të faturave dhe detyrimeve të prapambetura në shumën 8,7 miliardë lekë.

Ndërkohë u analizuan pagesat e kryera gjatë 7-mujorit të vitit 2018. Në zërin “shpenzime kapitale” u rezultua se pagesat e lidhura me fatura që mbajnë datën e vitit 2017 janë në vlerën 11, 5 miliardë lekë, duke treguar që gjatë vitit 2017 detyrimet e prapambetura janë rritur dhe deklarimet e faturave të prapambetura nga institucionet e ndryshme shtetërore janë të pasakta dhe të paplota. Sipas të dhënave të përpunuara gjendja e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2017 duhej të ishte raportuar të paktën 19 miliardë lekë nga 16,4 miliardë e raportuar si shpenzim i periudhave të ardhshme nga Ministria e Financave. Kjo shifër në gjykimin e KLSH-së është më e lartë duke marrë në konsideratë edhe llogaritë e tjera të shpenzimeve dhe pasaktësitë e konstatuara në datat e regjistrimit të faturave.

Procesi i kontraktimit të të mirave dhe shërbimeve publike nëpërmjet procedurave të prokurimit fillon pa marrë konfirmimet e nevojshme në lidhje me disponueshmërinë e fondeve në dispozicion në momentin e inicimit të procedurës së prokurimit. KLSH-ja konstaton se regjistrimet e urdhër-prokurimeve në Sistemin Informativ Qendror janë formale, pasi në mbi 80% të rasteve ato janë regjistruar pas firmosjes së kontratës. Pra, urdhër-prokurimi është regjistruar vetëm për efekt të plotësimit të fushave që lejojnë më pas krijimin e dokumentit: kontratë dhe pagesë respektive. Nga krahasimi i të dhënave të SIFQ-së me të dhënat e APP-së nga 41 raste të zgjedhura për testim në 17 prej tyre rezulton se urdhër -prokurimet janë të regjistruara në vitin 2017 në APP, ndërsa në SIFQ janë regjistruar në vitin 2018. Nga auditimi i të dhënave të urdhër- prokurimeve të regjistruara gjatë 7- mujorit të parë të vitit 2018, KLSH-ja konstaton se problemi i mosregjistrimit të të gjithë urdhër-prokurimeve nga të gjitha institucionet dhe mosregjistrimi në afatet e përcaktuara me qëllim konfirmimin dhe bllokimin e fondeve buxhetore disponibël, vazhdon të mbetet problematik.

KLSH-ja ka konstatuar se granti i buxhetit të shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për pushtetin vendor është tejkualuar përkundrejt planit me 6,2 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e këtij tejkualimi vjen nga fondi i mbartur për FZHR-në, i mbajtur nga viti 2016 në shumën 4,7 miliardë lekë, i pashoqëruar me plan buxhetor për vitin 2017.

Shpenzimet e financuara nga disbursimet e huasë së marrë për projekte specifike nuk janë raportuar për 3,8 miliardë lekë si pasojë e mosreflektimit të raportimeve të njëjësive së zbatimit të projekteve.

Sistemet e parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe marrja e angazhimeve pa fonde buxhetore megjithëse të ndërtuara nuk janë efikase. Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2017 konstatohet se janë likuiduar me një urdhër -shpenzim disa fatura njëkohësisht, kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet për atë periudhë në të cilën kryhet. Janë konstatuar edhe 131 raste në vlerën rreth 1,4 miliardë lekë. Auditimi evidentoi fenomenin e regjistrimeve të pasakta në SIFQ të urdhër-prokurimeve dhe të kontratave me vlera të fragmentarizuara, shpesh të barabarta me vlerën e faturës për t'u paguar dhe jo me vlerën e plotë të prokuruar, duke tejkualuar kontrollin për disponibilitetin e fondeve. Pra, institucionet me akses apo jo në SIFQ me ose pa dijeni të afateve ligjore për regjistrimin e çdo dokumenti për investim, nga urdhër-prokurime deri te fatura, në mënyrë të vetëdijshe nuk i zbatojnë këto afate, por autorizojnë regjistrime me vlera pjesore të barabarta me faturën dhe jo në vlerën reale të kontraktuar, si për shembull rasti i Bashkisë së Tiranës, FZSHH-në dhe institucioneve të tjera.

Një tjetër fenomen i konstatuar është rasti i pagesave pjesore të faturave me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël dhe mbartjen e detyrimit të mbetur nga vitet e mëparshme.

Pavarësisht shkeljeve nga njësitë publike, KLSH-ja konstaton se nuk raportohen informacionet mbi asnjë masat e marra kundrejt nëpunësve autorizues të institucioneve që marrin angazhime financiare pa fonde buxhetore, që kanë penguar dërgimin e faturave në thesar dhe nuk kanë zbatuar afatet e regjistrimit të kontratave të angazhimeve brenda afatit ligjor. Neni 71 e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar parashikon gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, në masën nga 1 deri në

3 paga mujore për regjistrimin me vonesë të kontratave dhe 3 deri 7 paga për moszbatim të afateve të dorëzimit të urdhër-shpenzimit. Kështu, gjobat e përlllogaritura, por të pavendosura për vonesat e dorëzimit të faturave në thesar vlerësohet të ishin minimalisht rreth 7 miliardë lekë.

Fondi rezervë i buxhetit të dhe fondi i kontigjencave.

Në përdorimin e këtyre fondeve referuar fondeve të miratuara të buxhetit të shtetit, është ruajtur kufiri ligjor prej 3%. Nga auditimi i dosjeve të vendimeve për përdorimin e fondit rezervë të buxhetit të shtetit statusi i problematikave mbetet i njëjtë me vitet e kaluara, kështu: Në 5 VKM-të në vlerë 19 milionë lekë, vendimet janë marrë me vonesë për likuidimin e vendimeve të Gjykatës Europiane. Në 3 VKM, në vlerën 136,755 mijë lekë, në dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave nuk janë relacionet shpjeguese. Në 4 VKM-të në vlerën 212,254 mijë lekë, dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave nuk kanë preventiv të shpenzimeve. Në 4 VKM-të në vlerën 210,747 mijë lekë nuk janë miratimet e Ministrisë së Financave për përdorimin e këtij fondi. Në 4 vendime të Këshillit të Ministrave në vlerë 162,128 mijë lekë, fondi rezervë është përdorur si “shtesë buxheti”.

Nga auditimi i dosjeve të vendimeve për përdorimin e fondit të kontigjencave, rezultoi se për vitin 2017 fondet e kontigjencave nuk janë përdorur sipas përcaktimeve të ligjit organik të buxhetit: Nga Ministria e Financave nuk jepet shpjegim pse fondi i kontigjencave nuk është përdorur sipas këtyre planifikimeve.

Fondi për ish- të përndjekurit politikë për vitin 2017 është realizuar në vlerën 2,298 milionë lekë, sipas tabelës fiskale, nga 2,352 milionë lekë të planifikuara në aktin normativ nr. 3. Vlera e njohur e detyrimeve, por ende e papaguar në fund të vitit 2017 është rreth 31,450 milionë lekë. Nëse buxheti dhe çelja e fondit për ish- të përndjekurit do të vazhdojë të mbajë ritmet e deritanishme me afërsisht 2 miliardë lekë në vit dhe ky detyrim do të mund të shlyhet vetëm pas 16 vjetësh

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve ka pasur një programim jo efektiv për vitin 2017, duke mos financuar një nga tri shtyllat kryesore përbërëse të tij konkretisht shtyllën e tretë “Programi i mbështetjes për ekonominë” dhe duke dështuar në ofrimin e mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro apo të mesme. Realizimi në tabelën fiskale për programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” nuk është i saktë, pasi mungon raportimi për 10 projekte, si dhe evidenca

plan-fakt e Drejtorisë së Thesarit për këtë program nuk rakordon me evidencën plan/fakt të Drejtorisë së Buxhetit. Fondi i mbartur në vitin 2017 për programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” në tabelën fiskale rezultoi me realizim ndërkohë që nuk ka planifikim.

Financimi nga buxheti i shtetit për të balancuar skemën e sigurimeve shoqërore dhe skemën e sigurimit të kujdesit të detyrueshëm shëndetësor paraqitet në nivele të larta dhe riskon në vijimësi me anë të transfertave për balancimin e pagesave si pasojë e deficitit specifik. Deficiti i degës së pensioneve për vitin 2017 rezultoi në shumën 27,458 milionë lekë, ose rreth 817 milionë lekë më pak nga plani fillestar prej 28,275 milionë lekë. Ky tregues u rrit me 317 milionë lekë apo rreth 1% më shumë, në krahasim me vitin 2016, ku deficiti ishte vetëm 27,141.5 milionë lekë. Ndërsa në raport me PBB4 ky tregues është përmirësuar nga 1.77 pikë në vitin 2016, në 1.03 pikë në vitin 2017.

Deficiti i degës së pensioneve të fshatit, ka rezultuar 11,371 milionë lekë, nga 11,593 milionë lekë të një viti më parë, pra 222 milionë lekë më pak. Edhe pse në vlerë nominale, rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar, deficiti i skemës konsiderohet i lartë, nëse konsiderojmë që skema mbulon vetëm 21.4% të numrit të përgjithshëm të përfituesve. Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura, vetëm 5 %, vërehet se zë një peshë relativisht të konsiderueshme në totalin e deficitit prej 41 %. Për vitin 2017 deficiti i degës së pensioneve të qytetit është në shumën 16 mijë e 87 milionë lekë, nga 15 mijë e 548 që ishte një vit më parë.

Pra, këtë vit deficiti është më shumë, për 539 milionë lekë, ose 3 % më shumë se një vit më parë.

Skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor është vlerësuar me një menaxhim të dobët, si pasojë e administrimit joefektiv të fondeve në dispozicion. Skema e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është vlerësuar në menaxhim të dobët si pasojë e administrimit jo efektiv të fondeve në dispozicion. Nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor janë konstatuar mangësi, parregullsi në vendimmarrjet e organeve drejtuese të këtij institucioni, në menaxhimin e burimeve njerëzore, në administrimin e fondeve të rimbursimit të barnave, në monitorimin e kontratave të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, të lidhura me detyrat funksionale të

punonjësve të fondit, të cilët në çdo hap reflektojnë dobësi të sistemeve të kontrollit gjatë vitit 2017, me efekte të cilat llogariten në 3,865 milionë lekë.

Administrimi i buxhetit të pushtetit vendor. Për vitin 2017, sipas treguesve fiskalë të konsoliduar janë raportuar shpenzime për buxhetin vendor, të realizuara në shumën 46,487 milionë lekë nga 46,816 milionë lekë, pas shpërndarjes së Fondit Rezervë dhe Fondit të kontigjencës. Nga auditimi mbi shpenzimet e pushtetit vendor konstatohet se niveli i realizimit të shpenzimeve të financuara nga granti i buxhetit të shtetit për pushtetin vendor është realizuar në shumën 28,575 milionë lekë, nga 22,376 milionë lekë të planifikuar në formën e transfertave. Konstatohet se realizimi faktik i shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta paraqitet me realizim në shumën 17.9 miliard lekë nga 24 miliard lekë të planifikuara me aktin normativ nr. 3. Mosrealizimi në këto burime financimi paraqitet në rreth 6 miliard lekë.

Nga auditimi i të dhënave në Sistemin Informativ Financiar Qendror konstatohet se pjesë e tejkalimit të transfertave të pakushtëzuara kundrejt planit të miratuar, është regjistrimi pa plan shpenzimi i fondeve për infrastrukturën vendore dhe rajonale, për pjesën e projekteve të FZHR-së, të mbartur nga viti 2016. Sipas të dhënave të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, vlera e realizimit faktik të projekteve të mbartura është në shumën 4.7 miliard lekë. Për të mbajtur të paprekur treguesit fiskalë të vitit 2017, sipas planifikimit të ligjin nr.130/ 2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, nuk janë marrë masat e nevojshme, në mënyrë që të reduktoheshin shpenzimet kapitale me financim të brendshëm me ndryshimet përkatëse të planit, por është lejuar kryerja e shpenzimit pa plan për shpenzimet e programit të infrastrukturës vendore.

Frenimi i regjistrimit të shpenzimeve të pushtetit vendor ka ndodhur nëpërmjet kufizimit të kryerjes së këtyre shpenzimeve dhe vendosjes së limitit të përdorimit të KESH-it në dy muajt e fundit të vitit për 3, 4 miliardë lekë.

Referuar shkresës gati tri ditë pas aktit normativ nr. 3, datë 6. 11, 2017, konstatohet se në planifikimin e shpenzimeve për pushtetin vendor nuk është përfshirë disbursimi përkatës i nënhuasë së marrë për projektin e bulevardit verior të Tiranës, në vlerën 1646 milionë lekë.

Nga tabela e treguesve faktikë fiskalë të konsoliduar konstatohet se ky projekt është raportuar në shumën 1646 milionë lekë në seksionin e shpenzimit të buxheti vendor, të financuar nga financimi i huaj. Nga analiza e raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar, të publikuar nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, rezulton se fakti në lidhje me këtë projekt, në zërin e shpenzimeve të pushtetit vendor është zero, duke u riklasifikuar nga jashtë pas raportimit në tabelën fiskale. Në këtë mënyrë shpenzimet e zërit për buxhetin vendor janë nënvlerësuar në shumën 1646 milionë lekë.

Raportimi i treguesve fiskalë dhe deficitit.

KLSH ka konstatuar riklasifikime të kryera jashtë raportit standard të Sistemit Informativ Financiar Qendror, të lidhura me shpenzimet kapitale me financim të huaj, të cilat paraqitën në SIFQ shumën 30,258, ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskal të konsoliduar janë paraqitur në shumën 22,278 milionë lekë.

Shpenzimet për pushtetin vendor paraqiten në shumën 48,132 milionë lekë në SIFQ dhe janë të raportuara në shumën 46,487 milionë lekë në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Me ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, nuk janë miratuar fondet për shpenzimin kapital të pushtetit vendor nga financimi i huaj.

Huaja e kthyer në shumën 1,909 milionë lekë e raportuar në zërin hua e kthyer nga huadhënia neto, paraqitet e keqklasifikuar, duke qenë se sipas raportit të SIFQ, raportohet poshtë zërit të deficitit në zërin të tjera edhe riklasifikimi i saj ka efekt në shtesën e deficitit me 1,909 milionë lekë. Nga ana tjetër, huaja e kthyer nga huatë e dhëna si mbështetje buxhetore nga vitet e kaluara vlerësohet të jetë në shumën 262 milionë lekë. Efekti neto në deficit si pasojë e raportimit jo të saktë vlerësohet të jetë në shumën 1,647 milionë lekë, si diferencë ndërmjet huasë së kthyer për projektet e huaja dhe huasë së kthyer nga mbështetja buxhetore.

Raportimi i treguesve fiskalë dhe deficitit.

KLSH ka konstatuar riklasifikime të kryera mbas raportimit standard të sistemit informativ financiar qendror, të lidhura me shpenzimet kapitale me financim të huaj, të cilat paraqiten në shumën 30 mijë e 258 milionë lekë. ndërkohë, në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar janë paraqitur në shumë 22 mijë e 278 milionë lekë.

Duhet theksuar se edhe në raportin e përgatitur nga Ministria e Financave për borxhin publik, shpenzimet kapitale me financim të huaj raportohen në masën 27, 2 milionë lekë.

Shpenzimet për pushtetin vendor paraqiten në shumën 48 mijë e 132 milionë lekë dhe janë raportuar në shumën 46,487 milionë lekë në tabelën fiskale të konsoliduar.

Huaja e kthyer në shumën 1,909 milionë lekë e raportuar në zërin hua e kthyer nga huadhënia neto, paraqitet e keqklasifikuar, duke qenë se sipas raportit të SIFQ dhe sipas standardeve duhet të raportohet poshtë zërit të deficitit. Nga ana tjetër, hua e kthyer nga huatë e dhëna si mbështetje buxhetore nga vitet e kaluara vlerësohet të jetë në masën 262 milionë lekë. Efekti neto në deficit, si pasojë e raportimit jo të saktë, keqklasifikimit, vlerësohet të jetë në masën 1,647 milionë lekë.

Në zërin e huadhënies neto është raportuar mbështetje buxhetore për sektorin energjetik nga burime të brendshme, në shumën 1,500 milionë lekë, ndërkohë që nga auditimi është konstatuar se mbështetja buxhetore faktike për vitin 2017 rezulton në shumën 2,500 milionë lekë. Klasifikimi i gabuar nuk vlerësohet me ndikim në deficit, por në cilësinë dhe saktësinë e treguesve të raportuar të shpenzimeve.

Në total efekti i tejkalimit të deficitit të raportuar vlerësohet në masën 5,440 milionë lekë, e përbërë nga 3,793 milionë lekë si pasojë e diferencave të disbursimeve ndërmjet vlerave të pasqyruara si shpenzim nga thesari në krahasim me borxhin, dhe 1,647 milionë lekë si pasojë e riklasifikimit nga marrëveshjet e nënhuasë. Si rrjedhojë, deficitin e vlerësuar rezulton në masën 36,452 milionë lekë, duke tejkaluar kufijtë e vendosur me ligjin nr. 130/2016. Në të njëjtën kohë ndryshon edhe raporti i deficitit në raport me PBB, duke arritur vlerën prej 2.34%, pa marrë në konsideratë efektin e detyrimeve të prapambetura.

Nëse do të merrnim në konsideratë detyrimet e prapambetura, të llogaritura në masën 11.5 miliardë lekë, të krijuara vetëm gjatë vitit 2017, fatura të paguara në 7 mujorin e parë të 2018, dhe rritjen e stokut të rimbursimit të TVSH, 7.2 miliard lekë vetëm për vitin 2017, do të ishte raportuar një shifër tjetër në treguesit e deficitit fiskal.

Mbi raportimin financiar publik.

Kuadri i kontabilitetit të financave publike dhe i raportimit financiar është i paplotësuar prej vitesh, duke cenuar kështu vërtetësinë, plotësinë dhe transparencën e pasqyrave financiare. Megjithatë plani kohor i strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike është deri në vitin 2020, KLSH konstaton që progresi i bërë në lidhje me hartimin e bazës ligjore dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, nuk është i mjaftueshëm dhe objektivat në këtë fushë janë shumë vështirë të realizohet, duke pasur në konsideratë situatën aktuale të raportimit financiar publik.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka dorëzuar në Kuvend pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2017, dhe si rrjedhojë KLSH nuk jep një opinion në lidhje me to. Me detaje në këtë raport janë përshkruar disa nga problematikat kryesore, të lidhura me raportimin financiar publik.

KLSH-ja ushtroi një auditim pilot, asistuar dhe nga ekspert të SAI-t Polak, mbi pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga auditimi u konstatuan devijime materiale, të përhapura në pasqyrat financiare të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që rezultuan në një opinion të kundërt, duke qenë se nuk paraqesin situatën dhe performancën financiare pas riorganizimit të ministrive.

Procesi i riorganizimit, ka sjellë ndryshime me krijimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë, Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme.

Nga auditimet e zhvilluara nga KLSH-ja është konstatuar se procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare dhe buxhetit është realizuar vetëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, e cila është formuar nga bashkimi i ish-Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, ish-Ministrisë së Zhvillimit Urban, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Përqendrimi i borxhit publik drejt huamarrjes së huaj ka sjellë rritjen e ekspozimit ndaj riskut të normave të interesit.

Menaxhimi i likuiditetit paraqitet me dobësi të theksuara, i bazuar në një metodologji që ofron informacion të limituar dhe jo të konsoliduar nëpërmjet institucioneve kryesore shpenzuese dhe argëtuese.

Koordinimi ndërmjet strukturave të borxhit dhe likuiditetit është i dobët, duke u përqendruar vetëm te monitorimi i pagesave më tepër se sa menaxhimi i mirfilltë i flukseve hyrëse dhe dalëse.

Instrumentet e përdorura për menaxhimin e llogarive në monedhë të huaj nëpërmjet këmbimeve valutore dhe kontratave me agjentin fiskal të qeverisë rezultojnë të jenë kosto të lartë për shtetin, me inefficienca për kohën kur ato janë kryer.

Konstatohet se nevojat për financime nuk planifikohen siç duhet, duke marrë në konsideratë edhe disbursimin për borxhin e jashtëm, duke shkaktuar teprica në likuiditet, në llogaritë e qeverisë.

Këto teprica likuiditeti në valutë ekspozojnë stokun e mjeteve monetare kundrejt riskut të kurseve të këmbimit.

Gjendja e mjeteve monetare në të katër monedhat në fund të vitit paraqitet me rreth 12,000 milionë lekë në fund të vitit 2017 dhe përgjatë vitit arrin edhe në vlera prej 45 miliardë lekë. Sjellim në vëmendje se emetimi i Eurobondit me vlerë 500 milionë euro, do të ketë ndikime në nivelin e likuiditetit, tregun e brendshëm, si dhe të shoqërohet me kosto si rrjedhojë e përdorimit të kontratave SWAP.

Raporti i borxhit publik si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto është ende larg objektivave afatmesëm për minimizimin e tij me implikime afatgjata në ripagesat dhe shërbimit të borxhit. Stoku i borxhit publik të raportuar për vitin 2017, paraqitet i nënvlerësuar bazuar në respektimin e kërkesave ligjore për raportimin e tij dhe në respektim të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe ato të lidhura me raportimin e borxhit publik.

Nga auditimi konstatohet se deri në fund të vitit 2017, sipas vetëdeklarimeve të enteve buxhetore, të raportuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë akumuluar detyrime të prapambetura në shumën 16 miliardë lekë dhe sipas auditimit të KLSH-së vlera e detyrimeve të prapambetura ka rezultuar në shumën jo më pak se 19 miliardë lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura, është raportuar si shpenzim i periudhave të ardhshme. Nëse merren në konsideratë këto detyrime, stoku i borxhit publik të raportuar, nga 1088 miliardë lekë, do të ishte në rreth 1104 miliardë lekë, i cili në raport me PBB-në do të jepte një tregues të borxhit në nivelin mbi 71%. Nëse marrim në konsideratë edhe shlyerjen e stokut të rimbursimit të TVSH në vlerë 11 miliardë lekë, borxhi publik do të jepte një tregues në nivelin 72% të PBB-së. Në strategjinë “Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020”, është vendosur objektivi i arritjes së borxhit publik në nivelin 65.5% të PBB në fund të vitit 2017. Konstatohet se që nga hartimi i strategjisë niveli i borxhit publik është luhatur rreth niveleve 70-74% e PBB-së.

Koncensionet/PPP-të konstatohet se nuk janë të integruara në procesin e menaxhimit të investimeve publike, pasi nuk ka strategji të qartë për përdorimin e këtyre instrumenteve për financimin e nevojave për të mira dhe shërbime. Në shumë raste procesi i PPP-ve është të

iniciuara nga sektori privat. Mungesa e raportimit në procesin e buxhetimit, si dhe në pasqyrat financiare të konsoliduara, krijon kushtet për cenimin e plotësisë, saktësisë dhe transparencës së informacionit në lidhje me këto projekte.

Gjithashtu, KLSH-ja identifikon mungesë të theksuar të monitorimit të portofolit të PPP-ve ekzistuese, të analizës mbi implikimet e mundshme të ndryshimeve dinamike të faktorëve makroekonomikë dhe efektin e pritshëm mbi treguesit fiskalë. Referuar të dhënave aktuale në lidhje me 11 kontratat koncensionare rezulton se shpenzimet faktike nga buxheti i shtetit rezultojnë në shumën 6493 milionë lekë. KLSH-ja sugjeron që në planifikimin dhe realizimin e treguesve të borxhit është e rëndësishme që të merren në konsideratë këto kosto financiare që mbartin këto projekte, për sa kohë Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk raporton në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit, që kërkojnë që këto kontrata të raportohen në stokun e borxhit publik.

Huadhënia dhe mbështetja buxhetore për sektorin energjetik dhe ujësjellësit është ende një nga problemet që riskon buxhetin e shtetit duke detyruar transferta si pasojë e performancës së dobët të sipërmarrjeve të sektorit me kapital shtetëror. KLSH-ja ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 5391 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2017, si pasojë e mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse.

Raportimi i të drejtave të ligjshme të shtetit

Vlera e borxhit tatimor të raportuar nga DPT-ja në fund të vitit 2017 kap vlerën 95,5 miliardë lekë. Konstatohet se borxhi i raportuar ka një rënie me 51,6 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë, ndikuar nga efektet të Ligjit të Faljes nr. 33/2017 në vlerën prej 49,8 miliardë lekë, fshirjes së borxhit tatimor të akcizës me justifikimin e borxhit “të transferuar” drejt DPD-ja në vlerën 12.3 miliardë lekë, dhe rritjes së borxhit tatimor gjatë vitit me rreth 10,5 miliardë lekë. Subjektet aktive përbëjnë 45% të numrit total të subjekteve debitore dhe detyrimet e tyre janë në vlerë 44,927 milionë lekë ose 47% e totalit të borxhit. Subjektet pasive përbëjnë 55% e numrit total të subjekteve debitore dhe detyrimet e tyre janë në vlerë 50,578 milion lekë ose 53% e totalit të borxhit. Nga analiza e të dhënave, rezulton se 10 subjektet e para kanë 27.3% të shumës total të borxhit tatimor, ndërsa 50 subjektet e para kanë rreth 52.7% të vlerës totale të borxhit tatimor.

Nga ligji i faljes nr. 33/2017 kanë përfituar rreth 194.654 tatimpagues në shumën 49,826 milionë lekë për lloje të ndryshme detyrimesh tatimore apo penalitetesh, prej të cilave shuma e falur vetëm për 50 tatimpaguesit përfitues më të mëdhenj rezulton në 21,961 milion lekë ose rreth 44% e shumës totale të falur.

Vlera e borxhit doganor të raportuar nga DPD-ja në fund të vitit 2017 kap vlerën 23,95 miliardë lekë. Konstatohet se borxhi i raportuar ka një rënie me 841 milionë lekë në krahasim me një vit më parë. Nga analiza e të dhënave, rezulton se 74% të totalit të borxhit doganor në fund të vitit 2017 e zënë detyrimet e 20 debitorëve të mëdhenj. Nga Ligji i Faljes nr. 33/2017 borxhi doganor është pakësuar në shumën 1.83 miliardë lekë, ku 50,5% e kësaj vlerë është përfituar nga 20 subjekte.

Konstatohet se gjatë realizimit të amnistisë fiskale, janë fshirë nga regjistrat e borxhit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, detyrimet e akcizës për 49 tatimpagues me vlerë 12,3 miliard lekë, prej të cilave vetëm ARMO në vlerë rreth 10,7 miliard lekë, (këtu përfshihen detyrime, penalitete dhe kamatvonesa).

Raporti i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme

Nisur nga auditimi i procesit të monitorimit për efekt të përgatitjes së raportit vjetor, si dhe të konstatimeve nga auditimet e realizuara nga KLSH-ja, për efekte të zbatimit të buxhetit të vitit 2017, arrijmë në konkluzionin se opinioni i dhënë për efekte të Raportit Vjetor, lidhur me funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, nuk reflekton situatën reale të implementimit të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pasi kampioni i përzgjedhur nuk është përfaqësues, metodologjia e monitorimit nuk është aplikuar siç duhet dhe ajo që është më e rëndësishmja bazohet në vetëm në përpunimin e pyetësorëve të vetëdeklarimit të njësive të sektorit publik. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk reflekton kapacitete teknike dhe profesionale që të garantojnë monitorimin e vazhdueshëm dhe ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e situatës. Përqendrimi i aktivitetit monitorues për një periudhë 3- mujore ngre problemin e efektivitetit të këtyre strukturave dhe ineficenca në organizimin e punës.

Nga auditimi është konstatuar se nga ana e strukturave të harmonizimit të AB-së, nuk ka një analizë të plotë mbi nivelin e shtrirjes së auditit të brendshëm në sektorin publik, nuk ka një numër të saktë të njësive të cilat plotësojnë kushtet e nevojshme për ngritjen e njësive të auditimit në nivel qendror, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe shoqëri aksionare, me qëllim që të paraqesin drejtë nivelin e shtrirjes së këtij shërbimi dhe më pas për të kaluar në vlerësimin e cilësisë së tij në rang kombëtar. Raporti vjetor mbi Auditimin e Brendshëm në sektorin publik, bazohet në përpunimin e 119 strukturave AB-së, të cilat raportojnë pranë Drejtorisë së Harmonizimit të auditit të brendshëm. Nga evidencat e vëna në dispozicion rezultojnë 22 njësi me 1 auditues dhe 26 njësi me 2 auditues, pra gjithsej 48 njësi të ose 40% e sistemit AB janë në shkelje të ligjit nr.114/2015.

Erion Braçe – Zonja Naço, do t'ju lutesha ta përmbledhnit se keni vetëm 5 minuta kohë!

Faleminderit!

Manjola Naço - Përfshirë këtu dhe 15 njësi me eficiencë shumë të ulët (zero rekomandime apo gjetje përgjatë vitit 2017) e çon në 53% nivelin ku sistemi i sigurimit të cilësisë mungon ose nuk funksion.

Gjithashtu, janë konstatuar shkelje të përhapura të ligjit referuar ngritjes së strukturave, punësimeve jo sipas kriterëve ligjore po formale duke shtuar ineficiencën e sistemit.

Referuar treguesit të dobishmërisë së aktivitetit të brendshëm, ai rezulton 14,9 lekë për 1 lekë të shpenzuar, duke përfshirë këtu edhe gjetjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Nëse kjo gjetje me dëm ekonomik do të përjashtohej, treguesi i dobishmërisë në nivel sistemi do të ishte 3,4 lekë për 1 lekë kosto auditimi të shpenzuar.

Nga 155 auditime të planifikuara dhe të realizuara për efekt të buxhetit të vitit 2017, KLSH-ja ka konstatuar shkelje të ligjshmërisë financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 6066 milionë lekë ose 48,2 milionë euro. Mungesë të ardhurash apo shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit në vlerën 130,727 milionë lekë apo 1039 milionë euro.

Nga ana tjetër, për efekte të këtij raporti, KLSH-ja ka realizuar edhe auditimet e performancës, të cilat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 dhe gjysmës së parë të viti 2018 arritën në 16 auditime performance, duke mbuluar fushat respektive: reformat qeveritare, menaxhimi i

borxhit publik, strategjia antikorrupsion, varfëria në Shqipëri dhe roli i shtetit në zbutjen e saj, performanca e arkivit shtetëror, të ardhurat e pushtit vendor, projekte mjedisore dhe energjetike, ku përfshihen cilësia e ajrit, menaxhimi i mbetjeve spitalore, zonat e mbrojtura bregdetare, shërbimet social-kulturore, performanca e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në zhvillimin e sportit; shërbimet sociale –ekonomike, efektiviteti i granteve të AZHBR-së, cilësia e ndërtesave shkollore, kostimi i shërbimeve spitalore, unifikimi i pikave doganore me Kosovën, performanca e ISHTI-t, projekte infrastrukturore, urgjenca mjekësore, receta dhe nënshkrime elektronike.

Mesazhet e dhëna në përfundim të këtyre auditimeve, më gjerësisht i keni të trajtuara brenda këtij raporti të prezantuar pranë jush.

Raporti i zbatimit të buxhetit të paraqitur pranë këtij komisioni është shumë dimensional, i cili nuk mund të përfaqësohet nëpërmjet gjetjeve kryesore apo prezantimit të shkurtër që unë sapo dhashë.

Duke u fokusuar kryesisht në treguesit dhe risqet kryesore fiskale, mendojmë se nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por jo vetëm, do të arrijmë të përmirësojmë sistemet e planifikimit, zbatimit, monitorimit të buxhetit dhe të ulim risqet potenciale të identifikuar nëpërmjet këtij raporti.

Faleminderit!

Erion Braçe – Edhe kaq i shkurtër nuk ishte zonja Naço.

Faleminderit për raportin tuaj!

Fjalën e ka zonja Gjylameti, si relatore e komisionit, lidhur me projektligji “Për buxhetin faktit të viti 2017”.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të mundohem maksimalisht që prezantimi im të jetë shumë herë më i shkurtër se dy prezantimet e mëparshme për sa kohë që edhe ministri, por edhe zonja Naço, që bëri prezantimin e opinionit të KLSH-së, diskutuan gjerë e gjatë për të gjitha aspektet e buxhetit faktit të vitit 2017.

Ky projektligj shqyrtohet sipas neneve 158 dhe 164 të Kushtetutës; nenit 63 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 31 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë

të Shtetit”; ligjit nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar; si dhe ligjit të ISHT-së nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, Këshilli i Ministrave ka paraqitur në Kuvend projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2017”, të shoqëruar me raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka paraqitur raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017, ku pasqyrohet opinioni i institucionit mbi përputhshmërinë e hartimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit të shtetit për vitin 2017.

Buxheti i vitit 2017 u ndryshua me dy akte normative, të cilat ruajtën të pandryshuar nivelin e planifikuar të treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë, për të mbështetur objektivin e qeverisë për forcimin e qëndrueshmërisë fiskale të vendit.

Zhvillimi i ekonomisë dhe buxheti i vitit 2017 ka disa karakteristika kryesore, siç janë:

1. Përshpejtimi i rritjes ekonomike dhe ndikimi i ndërsjellë në treguesit e tjerë ekonomikë.

Gjatë vitit 2017 ekonomia shqiptare vijoi trendin pozitiv dhe përshpejtues të rritjes ekonomike, duke arritur nivelin më të lartë vjetor pas vitit 2008. Rritja reale e PBB-së në vitin 2017, arriti nivelin 3,8%, nga 3,4%, që ishte një vit më parë. Ky nivel i realizuar i rritjes ekonomike ishte i njëjtë me parashikimin në fillim të vitit. Rritja ekonomike në Shqipëri është ndër më të lartat e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo performancë e ekonomisë sonë është vlerësuar pozitivisht nga të gjitha institucionet mbikëqyrëse ndërkombëtare, si Komisioni Europian, FMN-ja dhe Banka Botërore.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike e dhanë ndërtimi, tregtia, industria dhe aktivitetet financiare. Nga pikëpamja e shpenzimeve, rritja ekonomike u gjenerua nga kërkesa e brendshme, nëpërmjet rritjes së konsumit dhe investimeve totale.

Rritja ekonomike u reflektua në zgjerimin e tregut të punës. Norma mesatare vjetore e papunësisë për popullsinë mbi 15 vjeç arriti nivelin 14,1%, nga 15,6%, që ishte një vit më parë.

Vlen për t’u theksuar fakti se Shqipëria është një ndër vendet me nivelin më të ulët të normës së papunësisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në 3-mujorin e katërt të vitit 2017 treguesit e punësimit arritën një përmirësim të mëtejshëm me një normë rritjeje prej 3,4%.

Inflacioni mesatar për vitin 2017 arriti kufirin e poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 2%, nga 1,3% që ishte një vit më parë. Në aspektin makroekonomik, kjo ecuri pasqyron stadin e zhvillimit ciklik të ekonomisë sonë dhe nivelet e ulëta të inflacionit të importuar. Parashikimet janë që inflacioni të arrijë objektivin brenda vitit 2019.

Për sa i përket sektorit të jashtëm, një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2017 u arrit në drejtim të eksporteve, të cilat u rritën me 12,1%, ndërkohë që importet e mallrave u rritën me 8,1%.

2. Forcimi i stabilitetit makroekonomik e fiskal

Prioriteti kryesor i buxhetit 2017 ishte forcimi i stabilitetit të financave publike, i cili u shpreh nëpërmjet reduktimit të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik dhe arritjes së një balance primare pozitive, duke zbatuar kriteret dhe rregullat fiskale të parashikuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Realizimi i këtyre treguesve paraqitet si më poshtë: defiçiti buxhetor u realizua sipas objektivit të parashikuar në fillim të vitit, në nivelin 2% të PBB-së; bilanci primar faktik ishte pozitiv; borxhi publik faktik në fund të vitit 2017 ishte 70% e PBB-së, duke u reduktuar me 2,4 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë.

3. Rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, faktor i rëndësishëm për konsolidimin fiskal.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, gjatë vitit 2017, vijuan trendin në rritje, të filluar që prej vitit 2014. Në vitet e mëparshme 2011-2013 ky trend ka qenë në rënie. Kjo rritje e të ardhurave ka qenë një ndër faktorët kryesorë të konsolidimit fiskal. Në kushtet kur niveli i tatimeve dhe taksave nuk është rritur, rritja e të ardhurave ka ardhur kryesisht nga impakti i rritjes ekonomike, përmirësimi në administrimin fiskal, thellimi i luftës kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, si dhe rritja e shkallës së zbatimit të ligjit nga tatimpaguesit.

Politikat fiskale të zbatuara gjatë vitit 2017 synuan thjeshtimin e procedurave administrative dhe mbështetjen e biznesit, duke ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike. Ato nuk patën qëllim uljen e taksave, por bënë korrigjime në disa zëra të veçantë të tatimeve dhe taksave, si: akcizat, taksat kombëtare apo tarifatat doganore.

Ndikimin kryesor në rritjen e të ardhurave e dhanë të ardhurat tatimore dhe brenda tyre, të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat zënë peshën kryesore në të ardhurat e përgjithshme të buxhetit. Ndikim të rëndësishëm patën edhe të ardhurat nga fondet speciale, të

cilat arritën performancë pozitive për shkak të rritjes me 37 mijë të numrit të kontribuuesve, si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve.

4. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit dhe përmirësimi i cilësisë së tyre, si faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe konsolidimin fiskal

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për vitin 2017 arritën nivelin 461,4 miliardë lekë, duke u rritur me 27,7 miliardë lekë ose 6,4 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm.

Një tipar i rëndësishëm i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit është përmirësimi i cilësisë së tyre, duke i dhënë prioritet rritjes së shpenzimeve kapitale përkundrejt shpenzimeve korrente. Kjo duket në faktin që ritmi i rritjes së shpenzimeve kapitale është 5 herë më i lartë se i shpenzimeve korrente. Gjithashtu, struktura e shpenzimeve në vitin 2017, krahasuar me një vit më parë, ka ndryshuar në favor të shpenzimeve kapitale.

Investimet publike arritën ritmin më të lartë të rritjes që prej vitit 2008. Ato u rritën me 15,1%, krahasuar me një vit më parë dhe kjo rritje u arrit si në investimet me financim të brendshëm, ashtu edhe në ato me financim të huaj. Kështu, rritja e investimeve publike ishte faktori kryesor, që mbështeti rritjen ekonomike, rritjen e punësimit dhe zgjerimin e veprimtarisë së biznesit.

Për sa i përket përmirësimit të menaxhimit të financave publike vendore, gjatë vitit 2017 vijoi zbatimi i reformës administrative territoriale dhe filloi zbatimi i ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore duke sjellë përmirësimin e menaxhimit të financave publike vendore. Kjo ndikoi në rritjen e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe rritjen e shpenzimeve në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Përmirësimi i menaxhimit të borxhit publik. Gjatë vitit 2017 ecuria e borxhit publik ka qenë pozitive, në përputhje me objektivat e parashikuara në kuadrin makroekonomik dhe fiskal afatmesëm, strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik, si dhe në ligjin organik e vjetor të buxhetit.

Objektivi i kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm është reduktimi i borxhit publik për ta kthyer atë në një nivel me qëndrueshmëri më të lartë. Në linjë me këtë objektivi, stoku i borxhit publik u reduktua për të dytin vit radhazi, nga 73% e produktit të brendshëm bruto në vitin 2015, në 72,4% të produktit të brendshëm bruto në vitin 2016 dhe në 70% të produktit të

brendshëm bruto në vitin 2017. Pritshmëritë janë që të vijojë rënia e nivelit të borxhit edhe në periudhën afatmesme.

Në linjë me ligjin “Për buxhetin e vitit 2017” u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi plotësimin e nevojave të qeverisë për likuiditet, rifinancimin e borxhit ekzistues dhe financimin e deficitit të planifikuar.

Në linjë me objektivat e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik, u realizuan me sukses objektivat në kuadër të përmirësimit të raportit mes kostos e risqeve, si dhe përmirësimit të tregut të titujve shtetërorë.

Pika 7 ka të bëjë me vijimin e thellimit të reformave strukturore dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorëve prioritarë. Gjatë vitit 2017 vijuan dhe u thelluan më tej reformat strukturore në ekonominë e vendit. Rëndësi të veçantë iu kushtua mbështetjes së vazhdueshme buxhetore ndaj sektorëve prioritarë të ekonomisë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura. Gjithashtu, vijuan dhe u thelluan reformat në sektorin e ujit, energjisë, pensioneve, financave publike, administratës publike, reformës administrative territoriale dhe reformës në drejtësi. Vijimi me sukses i këtyre reformave ndikoi në realizimin e objektivave prioritare të ekonomisë së vendit, në mbështetje të veprimtarisë së biznesit, si dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Përpara se të kaloj në rekomandimet e Komisionit të Ekonomisë, dua t’i bëj disa pyetje ministrit të Financave dhe përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Së pari, pyetjet për ministrin e Financave dhe Ekonomisë. Cilat janë rrisqet e një viti elektoral dhe si kanë reflektuar në financat publike gjatë vitit 2017?

Meqenëse buxheti faktik është për vitin 2017, që ishte një vit elektoral, si ka ndikuar në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave?

Pyetja e tretë, sa rëndësi ka suficiti primar, që ndikon në qëndrueshmërinë e financave publike?

Pyetje e katërt, a ka pasur një skanim të treguesve të financave publike nga investitorët e huaj apo nga bankat, që kanë drejtuar procesin e emetimit të eurobondit?

Pyetja e fundit, cilat janë politikat kryesore të vitit 2017-2018 që do të vijojnë dhe do të shërbejnë si bazë për projektbuxhetin e vitit 2019?

Për sa u përket pyetjeve të përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e para, dua të di për ecurinë e dëmit ekonomik ndaj buxhetit e krahasuar me vitin 2016 dhe më parë?

A keni ndonjë informacion për pjesën e dëmit ekonomik të zhdëmtuar nga subjekte apo persona që kanë kryer shkelje ligjore?

Për sa u përket rekomandimeve, Kuvendi është në prag të shqyrtimit të projektbuxhetit të vitit 2019, në këtë kuadër rritja e cilësisë së planifikimit buxhetor është një detyrë aktuale dhe mjaft e rëndësishme. Kjo kërkon koordinimin më të mirë të kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm me buxhetin vjetor, shmangien e parashikimeve optimiste dhe hartimin e një buxheti sa më realist dhe eficient me objektiv nxitjen e rritjes ekonomike dhe forcimin e qëndrueshmërisë fiskale të vendit.

Ministria e Financave duhet të rrisë shkallën e ndërveprimit të bazave të dhënave mes drejtorive të tatimeve, doganave dhe gjithë strukturave që marrin pjesë në mbledhjen e të ardhurave apo ekzekutimin e shpenzimeve të buxhetit, duke kryer investime në sistemet e teknologjisë së informacionit.

Rritja e disiplinës financiare në zbatimin e buxhetit mbetet një detyrë e përhershme, e cila kërkon njohjen e vazhdueshme të akteve ligjore e nënligjore dhe forcimin e shkallës së zbatimit të ligjit. Kjo do të ndikojë në minimizimin e shkeljeve ligjore me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit krahas konstatimeve të parregullsive dhe shkeljeve ligjore me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, duhet të kishte paraqitur në mënyrë më të plotë masat dhe rekomandimet e propozuara nga ky institucion. Kjo pjesë e raportit duhet të plotësohet dhe të dërgohet sa më shpejt në strukturat ekzekutive, të cilat janë zbatuese të këtyre masave dhe rekomandimeve. Gjithashtu, duhet të dërgohet për informim dhe për ndjekje pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave me qëllim forcimin e punës për minimizimin e parregullsive dhe shkeljeve ligjore me ndikim në buxhetin e shtetit.

Gjatë vitit 2019 dhe në vijim, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të kryejë auditime me fokus të veçantë për buxhetin e shtetit dhe të informojë në mënyrë periodike Komisionin për Ekonominë dhe Financat për problematikat e konstatuara. Kjo do të ndihmojë në ndjekjen e zbatimit të buxhetit gjatë gjithë vitit, pa u kufizuar vetëm në periudhën e shqyrtimit të buxhetit faktik për vitin e mëparshëm.

Mbledhja e borxhit tatimor dhe doganor duhet të përmirësohet me qëllim që ndikimi i tij në buxhetin e shtetit të reduktohet. Kjo kërkon forcimin e punës së administratës tatimore doganore për ndjekjen dhe mbledhjen e detyrimeve të papaguara nga subjektet përkatëse.

Për sa i përket procesit të rimbursimit të TVSh-s, duhet të përmirësohet me qëllim që detyrimet e shtetit ndaj subjekteve tatimore të paguhen brenda të gjitha afateve ligjore. Kjo do të ndikojë në rritjen e likuditetit të subjekteve të biznesit, si dhe në zgjerimin e veprimtarisë së tyre.

E fundit, vëmendje e veçante duhet t'i kushtohet forcimit të shkallës ndëshkuese dhe vënies përpara përgjegjësisë të personave që kanë kryer shkelje ligjore. Kjo do të ndihmojë në kryerjen e zhdëmtimeve ndaj buxhetit të shtetit, por edhe në rritjen e shkallës së zbatimit të kuadrit ligjor për buxhetin.

Mbështetur në të gjitha argumentet e mësipërme, i propozoj komisionit miratimin e projektligjit.

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fillojmë me përgjigjen e pyetjeve që bëri zonja Gjylameti.

Arben Ahmetaj – Po t'u referohemi risqeve të vitit fiskal 2017, si vit elektoral, në ligjin organik të buxhetit të ndryshuar me ligjin e vitit 2016, kemi vendosur kufizime në shpenzime për vitin elektoral. Ka qenë e zakonshme, të paktën në 25 vjet, që gjatë viteve elektorale parlamentare ka pasur një tendencë për shthurje të financave publike. Këto tendenca diku kanë qenë të vogla dhe diku të mëdha, duke sjellë një kthim mbrapa të menaxhimit të financave publike me vite. Tipik është viti 2013, ku praktikisht u deshën 4 vjet për të stabilizuar financat publike dhe ekonominë, si dhe për të rikthyer gjithë stabilitetin makroekonomik në bazë të shëndoshë.

Një nga risqet ishte qeveria e përkohshme e dalë nga marrëveshja e 18 majit, nëse mund t'i referohem kështu, ku praktikisht nuk kishte ministër Financash dhe as autoritete të tjera që mund të drejtonin me qëndrueshmëri politike. Ministrat teknikë vendosën të qëndronin larg çështjeve, përveç çështjes së aprovimit të udhëzimit për përmbarimin. E vetmja firmë që la gjurmë të rënda ishte firmosja e udhëzimit të përmbarimit, që është risk më vete dhe që mendoj se e korrektoam. Pra, nuk u morën me të ardhurat dhe me shpenzimet, por u fokusuan te çështjet e tyre, tek ato që ata mendonin se ishin të rëndësishme. Kjo bën që të mendojmë që pa një

autoritet politiko-profesional në krye të ministrive, buxhetet janë gjithmonë në risk, megjithatë risk tjetër janë detyrimet prapambetura.

Për sa i përket Ministrisë së Infrastrukturës, në gusht të vitit 2017 kishte akumuluar rreth 5 miliardë detyrime të prapambetura, të cilat i korrektuam me aktin normativ që bëmë më 11 gusht është i vitit 2017. Risku tjetër do të ishte, i cili fatmirësisht nuk u materializua, risku i jashtëm, që do të ngarkonte ndoshta koston e interesave apo kursi i këmbimit, i cili këtë vit bëri që vlerësimi i lekut deri në shtator të këtij viti të dëmtonte të ardhurat doganore me 6 miliardë lekë dhe besoj se do të vazhdojë t'i dëmtojë deri në fund të vitit nga 400 deri në 600 milionë lekë çdo muaj. Në të njëjtën kohë ka edhe një emocion politik, i cili hapet në vitet elektorale, projekte të reja për prerje shiritash hapjesh gjë që nuk ndodhi në vitin 2017, për shkak të rregullit buxhetor që ne vendosëm se nuk do të ketë asnjë hapje të një projekti të ri pa alokuar 20% të kostot totale në vitin korrent, gjë që frenoi konsiderueshëm hapjen elektorale të projekteve.

Fakti që ne, po i marr një nga një, zonja Gjylameti, të gjitha pyetjet tuaja, e mbyllëm vitin me sufiçit primar është domethënëse. Ju bëtë një pyetje se çfarë rëndësie ka sufiçiti primar. Kur dëgjohe në gjuhën teknike fjalët “suficit primar”, nuk i bën përshtypje askujt, por e thënë më thjesht për qytetarët, sufiçiti primar presupozon që qeveria nuk krijon borxh të ri mbi operacionet e veta, jo vetëm që nuk krijon borxh të ri, por ul borxhin e trashëguar. Në gjithë këtë histori ankora kryesore është deficitit faktik.

A mund t'i thuhet ti ministrit të Financave pse e mbylle vitin 2017 në datën 5 janar dhe nuk e mbylle pas 3 muajsh? Jo! Kushdo që ka qenë para meje dhe kushdo që do të jetë pas meje guidë kryesore ka deficitin dhe ditën që deficitit arrin nivelin zyrtar, atë ditë pritët viti, nuk diskutohet. Deficitit është i panegociueshëm, të tjerat janë hajde të flasim si të duam, jo kjo duhet kontabilizuar kështu, jo kjo duhet kontabilizuar ashtu, po të fusim këtë standard ndërkombëtar mund të ishte kjo. Patjetër të gjitha mund të jenë konsekuenca pozitive, por deficitit është i panegociueshëm dhe kjo është arsyeja pse unë i referohem sistemit informatik financiar të qeverisë me kolonën e deficitit faktik. Po t'i referoheni diskutimit që bëri me të drejtë Kontrolli i Lartë i Shtetit për huamarrjen neto, ja ku e keni huamarrjen neto, ia keni dhënë ju këtë të drejtë, parlamenti, ta konsiderojë mbi jo nën, këtu futemi në detajet teknike, Ministria e Financave.

Parlamenti me këtë ka bërë shumë mirë, me këtë të drejtë që na ka dhënë për hir të së vërtetës, sepse ne e kontrollojmë shumë më mirë huamarrjen neto dhe jo siç ishte dikur që nuk kontrollohej dot.

Për sa i përket skanimit nga investitorët, zonja Gjylameti, mund t'ju them që Fondi Monetar Ndërkombëtar vazhdon të na monitorojë, Banka Botërore na monitoron, Komisioni European na monitoron me programin e reformës ekonomike që kemi me ta dhe ndër vite për hir të së vërtetës Komisioni European do të zëvendësojë Fondin Monetar Ndërkombëtar si monitoruesi kryesor i financave publike. Kemi 4 vjet që punojmë me komisionin në reformën e mirëmenaxhimit të financave publike për ta përmirësuar menaxhimin e financave publike dhe këto janë rezultate, nuk janë mrekulli, këto janë konsekuencë e punës, nuk ka këtu asnjë surprizë, këto janë puna e përditshme e qeverisë, e Ministrisë së Financave konsekuente për të bërë atë që shihni atje.

Sa i takon skanimit, janë kompanitë e reitingut, të cilat janë shumë të ftohta. Shembulli që po diskutojnë me Italinë është fare i thjeshtë. Italia është ende një ndër 7 ekonomitë më të mëdha të botës, e megjithatë kompanitë e reitingut janë shumë të ftohta në gjykimin që i bëjnë kësaj ekonomie. E njëjta gjë ndodh edhe me ne. Ne skanoheci çdo muaj dhe rezultatja ishte që ne arritëm, të falënderoj për pyetjen, të emetonim një bono europiane, eurobond, me një kupon çmimi 3,5% që është realisht një sukses i ekonomisë dhe nuk ka të bëjë fare me shifrën. Shifra është shifër që na duhet ne për të riskeduluar borxhet e shtrenjta me borxhet me likuiditete më të lira, ndërsa borxhi publik në rënie është rezultante e reformave dhe ato reforma kanë qenë referencë në sytë skanues të investitorëve, të tregjeve kapitale për të marrë pjesë në financimin e operacioneve të qeverisë me një bono 3,5. Më vjen mirë t'ju them se në atë moment 3,5 ishte më lirë se Maqedonia, sepse Maqedonia nuk është si ne B-stabël, por është 2B, Mali i Zi, i cili mendohej se ishte më mirë, atë ditë kuotohej në 3,95.

Tani po ju them se si ankorohemi, se si spirancohet vlerësimi për ekonominë shqiptare në tregjet ndërkombëtare financiare që ta dinë të gjithë qytetarët, çmimi i Italisë plus 100 basis point ose 1% ne, ndërsa Italia atë ditë ishte 3,4% dhe normalisht ne duhej të merrnin një bono, kupon-çmim 4,4%. Investitorët kanë besim tek ekonomia shqiptare dhe ajo që dua t'ju them, imagjinoni për një sekondë që përveç gjithë institucioneve financiare dhe atyre që menaxhojnë asetet ka 3 investitorë tek ekonomia shqiptare specifike që bëjnë diferencë cilësore, është fondi i

pensioneve të Norvegjisë, është fondi i pensioneve i kompanisë së hekurudhave të Francës, kompani publike, të cilat kanë hedhur të gjithë sigurinë e pensioneve të tyre te besimi që kanë për ekonominë shqiptare, për të mos folur më pas për Goldman Saks, për Xhepi Morgan, për Pimpko, për Aberdin, të cilat janë fonde me 1,3, 1,4 dhe 1,5 trilionë euro ku çdo qeveri, çdo vend, çdo sovran do të dëshironte t'i kishte si investitorë.

Sa u takon të ardhurave, më duhet t'ju them se ne kemi nevojë të bëjmë akoma më shumë për rritjen e të ardhurave. Edhe pse rritja ishte e konsiderueshme, unë besoj se kemi shumë punë për të bërë me të ardhurat. Qeveria shqiptare po bën një investim shumë serioz për vitin tjetër sa i takon fiskalizimit dhe më besoni që me atë profil që ka teknologjia e mundshme dhe investimi do të bëjë të mundur skanimin e çdo transaksioni në kohë reale, qoftë biznes konsumator, qoftë biznes me biznes.

Mund të bëjmë një analizë fare të thjeshtë, sepse përtej kësaj salle jemi bërë të gjithë analistë, por një ankorë, një spirancë është e panegociueshme. Diskutimi fillon nga rritja ekonomike, ndërsa më pas diskutimi emocionalo-politik-social, që është legjitim, a mjafton kjo rritje, është diskutim më vete, por Shqipëria po rritet ekonomikisht dhe kjo nuk është një rritje e rastësishme. Pse? Sepse cilësia e rritjes praktikisht shpërndahet në disa sektorë, janë shërbimet, ndërtimi, të cilat nuk janë më si dikur. Ne kemi industrinë në tërësi, ku vitin e kaluar u rritëm me 3,8%, meqë jemi duke folur për vitin e kaluar, ndërkohë që energjia po bënte goditje për shkak të klimës dhe për shkak të thatësisë. Pra, prodhimi ra me 46% dhe prapë u rritëm me 3,8% dhe kjo tregon që qëndrueshmëria e rritjes ekonomike është futur në rrugë të mbarë.

Po të doni, diskutojmë nëse mjafton apo nuk mjafton, sa u ul papunësia, si mund ta përmirësojmë shpejtësinë, sepse të gjitha këto janë të vlefshme. Duke marrë shkas nga pyetja juaj, diskutimi dhe debati ynë me Kontrollin e Lartë të Shtetit është shumë i shëndetshëm. Elementet që ngriti përfaqësuesja e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë të bëjnë me detyrimet e prapambetura, kanë të bëjnë me mënyrën sesi hapen prokurimet, kanë të bëjnë me mënyrën sesi funksionon FZHR-ja, kanë të bëjnë me mënyrën sesi kontabilizohen detyrimet, kanë të bëjnë me mënyrën sesi të bëhemi më transparent janë rekomandime të denja. Nuk po i referohem fare debatit se sa familjarë janë me sistemin informatik financiar të qeverisë, sepse ai është një proces. Pasi të kemi afmisiin do të zgjerojmë njohuritë tona. Duke iu referuar pyetjes suaj për politikën e viteve 2017-2018, në vitin 2017 kishim politika përveç paketës fiskale që lehtësoi

barrën fiskale për sipërmarrjen. Dje kisha një takim në Këshillin e Investimeve sa i përket turizmit. A e dini sa ishte rritur deklarimi për tre muaj i industrisë së turizmit? 5,6 miliardë. Nuk ka ndodhur kurrë. Përfitimi nga ulja e normës së reduktuar të TVSH-së prej 6% shkante në 587 milionë lekë. Dikush mund të pyesë a u ulën çmimet? Jo, nuk u ulën. Ky është një diskutim patjetër legjitim, por nuk ka rëndësi këtë moment, sepse unë mund të them për çfarë e përdorën gjithë atë normë të reduktuar. E përdorën për të ulur çmimet? Diku po. E përdorën për të zgjeruar investimin? Diku po. Pra, na funksionoi politika dhe politika fiskale i referohet ngritjes ekonomike. Ajo është ankora kryesore ku praktikisht fillon analiza, që vazhdon me cilësinë e rritjes, me qëndrueshmërinë e rritjes dhe me shpejtësinë e rritjes referuar një sektori, e referuar në konsum, në rritje investimesh, dhe te punësimi. A e dini që janë 670 mijë vende pune? A e dini që 234 mijë vende pune janë krijuar në 4 vjet? Kjo do të thotë që gati 35% e vendeve të punës janë krijuar në 4 vjet. Kurrë nuk janë mjaft, sidomos për pritshmërinë e një vendi që la pas krizën greke. Kollaj është të ulësh borxhin? Kollaj është të bësh konsolidim fiskal, ndërkohë që vendi ka nevojë për investime, apo të ruash balancën korrente me 3 %? Sigurisht, nuk është mrekulli, por është punë, është angazhim politik i një qeverie dhe i një maxhorance për të bërë gjënë e duhur. Është kollaj të vish e të thuash të rrisim borxhin, se ka nevojë për investime. Atë që ti e rrit në njërin anë të buxhetit, ta merr tregu me rritje kostosh në anën tjetër. U ktheve mbrapa. Ato ekspansionet fiskale që ti bën, nuk i korrigjon dot më, ndërsa koston këtu e ke në kurriz, do ta përballosh, nuk diskutohet.

Meqë iu referuat vitit 2017 politika kryesore përveç konsolidimit të llogarisë kapitale në nivelin 5%, duke futur edhe sistemin energjetik, ishte futja e 600 mijë shqiptarëve brenda sistemit të rimbursimeve dhe atyre që nuk kanë siguracion. Ky është një diskutim në Komisionin e Ekonomisë, por unë dua të sqaroj qytetarët që janë 600 mijë qytetarë, që nuk kanë sigurim as shëndetësor. Ky nuk është vend i pasur, por një vend, i cili po hyn te vendet në zhvillim vetëm për shkak të reformave. E, megjithatë, në një ditë të vështirë të vetën vendos të futë brenda sistemit të rimbursimeve 600 mijë qytetarë për të treguar që nuk lë njeri pas edhe në ditë të vështirë. Hajdeni të ballafaqojmë dy politika, një politikë të vitit 2013, ku të gjithë personat me aftësi ndryshe me aftësi të kufizuara nuk morën bukën e gojës, me politikën e vitit 2017 ku kjo qeveri vendos të fusë brenda strukturës së mbështetjes 600 mijë shqiptarë të pasiguruar. Nuk do t'u themi shqiptarëve pse nuk u siguroat. Patjetër që do të sigurohen, patjetër që është një proces,

por nuk mund dhe t'u thuash pse nuk u sigurove, tani rri vetëm atje. Jo nuk e bën kjo forcë politike këtë dhe nuk e bëri. U mendua që kostoja do të ishte 500 milionë, shkoi 1 miliard. Ne ulëm borxhin, ulëm deficitin, rritëm ekonominë dhe u përgjigjëm edhe për nevojat e kësaj shtrese që ishte lënë aty jashtë pa asnjë mbështetje.

Politika e teksteve falas, e cila po konsolidohet, shumë shpejt do të kemi bonusin e bebeve, përveç disa politikave dhe paketës fiskale që një pjesë e kemi kaluar, një pjesë do ta kalojmë në këtë komision, do të bënë diferenca të rëndësishme për shumë sektorë.

Faleminderit!

Lindita Lati – Zonja Gjylameti, doja të theksoja se nga viti 2016 KLSH-ja ka një qasje tjetër në auditim. E kemi theksuar në vijimësi se jemi duke zbatuar në përputhje të plotë standardet e auditimit INTOSAI. Kjo ka bërë që, përveç elementeve të dëmeve ekonomike, të cilat i kemi theksuar në periudhën e mëparshme, të ndalemi në parregullsitë dhe vlerësimin ose kuantifikimin e parregullsive dhe paligjshmërive, në ekzekutimin e të ardhurave dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, të cilat janë vlerësime sistemesh. Në vitin 2015 dëmi ekonomik dhe parregullsitë e kosntatuara për buxhetin e vitit 2015 është 34,7 miliardë lekë, në vitin 2016 dëmi dhe parregullsitë ose paligjshmëritë në ekzekutimin e buxhetit të shtetit janë 58,3 miliardë lekë kurse në vitin 2017 totali i efekteve negative dëme dhe parregullsi është 137 miliardë lekë.

Ajo që duhet të theksohet është që për sa i takon zhdëmtimit të dëmit apo ndjekjes së zhdëmtimit të dëmit KLSH-ja në mënyrë të vazhdueshme bën ndjekjen e rekomandimeve ose zbatimin e rekomandimeve, të cilat i raportojmë gjatë raporteve vjetore të KLSH-së. Për problemin e zhdëmtimeve nuk mund të shprehemi qartë pasi zhdëmtimi merr një kohë të gjatë për t'u realizuar. Kështu që nuk kemi tregues të matshëm në fund të çdo viti sa është niveli i dëmit të zhdëmtuar brenda një viti buxhetor. Të gjitha elementet ose dëmet e konstatuara nga ne kalojnë në procese gjyqësore të cilat mund të marrin më shumë se 3 vjet dhe e kemi të pamundur të kuantifikojmë brenda periudhave të caktuara raportuese se sa është niveli real i zhdëmtimit.

Erion Braçe- A ka pyetje të tjera?

Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votim.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për miratimin e e buxhetit faktik të vitit 2017”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA